

## Bibliotekat në Kosovë

Vlerësimi i përgjithshëm  
dhe plani i zhvillimit afatshkurtër  
dhe afatmesëm

Nga Carsten Frederiksen dhe Frode Bakken

**Misioni i përbashkët bibliotekar i  
UNESCO-s, KIE-së  
dhe IFLA-s/FAIFE-së**



*The remains of the main public library in the municipality of Malishevë (South-Western Kosovo), which was burned down July 1998.*

### 1. Përmbledhje

Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe profesionistët e bibliotekave në Kosovë përballohen me detyrën madhore të rekonstruktimit të ndërtesave të bibliotekave dhe rithemelimit të shërbimeve bibliotekare në të gjitha nivelet.

Ky është konkludimi i përgjithshëm prej një vlerësimi të situatës që ka të bëjë me bibliotekat, i kryer nga misioni i përbashkët i UNESCO-s, Këshillit të Evropës (CoE) dhe nga Federatës Ndërkombtare të Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare, IFLA.

Misioni është realizuar në periudhën prej 25 shkurtit, deri më 7 mars, nga z.Carsten Fredriksen, zëvendësudrejtor i Zyrës së IFLA-s/FAIFE-së në Kopenhagë të Danimarkës, dhe z.Frode Bakken, Kryetar i Shoqatës Bibliotekare të Norvegjisë. Misioni ka qenë zemërgjerësisht i përkrahur nga organizatat bibliotekare në Skandinavi.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare dhe biblioteka të tjera të veçanta janë duke u shkatërruar, ruajtja e materialeve të shkruara është e rrezikuar dhe sistemet nacionale për t'i regjistruar dhe shpërndarë dokumentet janë praktikisht jashtë funksionit. Pjesë të mëdha të koleksioneve të vlefshme në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare janë larguar dhe, me siguri, janë shkatërruar në periudhën prej 1990-1999.

Shumë biblioteka publike dhe shkollore, posaçërisht në fshatëra, janë djegur plotësisht, ndërsa të tjerave u janë marrë dhe shkatërruar koleksionet e librave, ndërsa ato të cilat ende veprojnë vuajnë prej pasojave të gati 10 vjetëve të lënies pas dore të furnizimeve. Në të njëjtën kohë, shumë libra tjerë janë djegur me djegien e shtëpive të përdoruesve. Diku rreth gjysma e furnizimeve të të gjitha bibliotekave publike kanë humbur. Një pjesë të madhe të librave të mbetura ose iu ka dalë koha ose janë irelevante për banorët lokale, për shkak të karakterit të tyre ideologjik, lingistik ose etnik. Praktikisht të gjitha pajisjet janë marrë dhe shumica e punonjësve të tashëm duhet të trajnohen pas një periudhe të gjatë pa praktikë profesionale dhe arsimim sistematik.

Nuk ka bashkëpunim, e as edhe kontakt, në mes të profesionistëve të shumicës shqiptare dhe profesionistëve në enklavat etnike serbe.

Në përgjithësi, ka një nevojë të madhe për dhoma leximi, literaturë të fëmijëve, literaturë bashkëkohore profesionale dhe qasje ndaj teknologjisë së re. Tash është e nevojshme përkrahja ndërkombëtare me fonde dhe ndihmë profesionale për t'i rikonstruktuar bibliotekat dhe një rrjet punues të bibliotekave.

Shërbimet bibliotekare mund të jenë një vegël e rëndësishme dhe shumë lehtë e përdorshme për promovimin e leximit, arsimin dhe kulturën në një rajon me pak ose aspak sende tjera të ofruara dhe për një popull me një pjesë të madhe të fëmijëve dhe të rinisë. Bibliotekat mund të çelin porta lokale kah dijenia, ta reflektojnë shumësinë dhe lloj-llojshmërinë e shoqërisë dhe ta përkrahin procesin e demokratizimit, sidomos në vendet si Kosova.

Misioni i Bibliotekës së Kosovës propozon një plan veprimi tre deri në katër vjetësh, Projektin e Bibliotekës së Kosovës 2000+, për riaftësimin dhe sforcimin e bibliotekave në Kosovë. Plani përfshin projekte afatshkurta dhe përpjekje për t'i treguar strategjitë afatgjata.

Plani propozon themelimin e një organi me punë në kohë të kufizuar, Konzorciumi i Bibliotekës i Kosovës, që duhet të përfshijë vepruesit vendor dhe donatorët e mëdhej ndërkombtar si dhe organizatat ndërkombtare që ofrojnë ekspertizë dhe këshilla profesionale. Brenda kësaj kornize do të mund të zhvillohej një plan më i hollësishëm dhe më i elaboruar.

Plani i veprimit përfshin themelimin e një vistre prej 11 programeve të veçanta, secili prej të cilëve do të mbulonte nevoja dhe aspekte të ndryshme të aktiviteteve bibliotekare:

1. Programi legjislativ dhe administrativ
2. Programi i shërbimit të bibliotekës lëvizëse
3. Programi i rindërtimit
4. Programi i librave dhe i leximit
5. Programi i teknologjisë informative
6. Programi i trajnimit dhe zhvillimit profesional
7. Programi i trashëgimisë kulturore
8. Programi i fëmijëve dhe rinisë
9. Programi i qasjes së hapur
10. Programi i mbështetjes së iniciativës
11. Programi i binjakëzimit

Programet e sugjeruara ndryshojnë për nga natyra dhe pesha financiare. Një vlerësim paushal i menjëhershëm i fondeve të duhura për masat themelore afatshkurta kap shumën prej 14 milionë DM.

Programi i parë i ravijëzon themelet strukturale mbi të cilat mund të bazohet procesi i rehabilitimit. Pesë programet, të cilave iu duhet iniciativë e menjëheshme dhe një pjesë e madhe e financimit nga jashtë, janë: Programi i Bibliotekave Lëvizëse, Programi i Rindërtimit, Programi i trajnimit dhe zhvillimit profesional, Programi i librave dhe i leximit dhe Programi i Teknologjisë informative. Ka korelacione të rëndësishme ndërmjet këtyre programeve: Rindërtimi i ndërtesave është detyrë afatgjate e cila mund t'i marrë disa vjetë. Për këtë arsye, sugjerohen bibliotekat lëvizëse si një iniciativë pak a shumë kompenzuese. Vetë ndërtesat nuk kanë vlerë pa libra, teknologji dhe profesionistë të kualifikuar të bibliotekave.

Programi i trashëgimisë kulturore ka për qëllim të ofrojë zgjidhje praktike për nevojat urgjente të ruajtjes dhe sigurisë. Programi i fëmijëve dhe rinisë dhe Programi i qasjes së hapur janë më shumë të një natyre bibliotekare politike me qëllimin që t'i reformojnë dhe t'i forcojnë disa aspekte të rëndësishme të rolit shoqëror të bibliotekave. Dy programet e fundit sygjerjnë themelimin e veglave të veçanta për ta siguruar dhe për ta promovuar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e vendësve.

---

## 2. Hyrje

Rezoluta 1244 e Këshilit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara i jep për detyrë Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut) "kryerjen e veprimeve themelore administrative civile" dhe "organizimin dhe mbikqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisjen demokratike dhe autonome" në Kosovë.

Që ta përgatisin një vlerësim të gjendjes së bibliotekave dhe për t'i themeluar udhërrëfyesit themelore, UNESCO-ja, Këshilli i Evropës dhe IFLA/FAIFE-ja, e kanë organizuar një mision ekspertësh për qytetet kryesore të Kosovës. Në kohën prej 25 shkurtit, deri më 7 mars, z.Carsten Fredriksen, zëvendës drejtor i zyrës së IFLA/FAIFE-së në Kopenhagë të Danimarkës, dhe z.Frode Baken, kryetar i Shoqatës së Bibliotekave të Norvegjisë, i kanë vizituar bibliotekat në të gjitha rajonet më të mëdha të Kosovës.

IFLA (Federata Ndërkombëtare e Shoqatave Bibliotekare) merret me rolin e bibliotekave në ndërtimin dhe mbajtjen e

demokracisë. IFLA/FAIFE-ja (Qasje e lirë në informata dhe liria e të shprehurit) është një iniciativë përbrenda IFLA-së për t'i mbrojtur dhe promovuar të drejtat themelore njerëzore të definuara në nenin 19 të Deklaratës Univerzale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Prioriteti numër një në punën e IFLA/FAIFE-së është që: "Ta promovojë lirinë e qasjes në informata dhe lirinë e të shprehurit si të drejta themelore njerëzore, që janë gurthemele me rëndësi jetike për misionin e bibliotekave dhe bibliotekistëve për t'i mbështetur të drejtat njerëzore, paqen, demokracinë dhe zhvillimin".

Komisioni dhe Zyra e IFLA/FAIFE-së e çon përpara qasjen e lirë në informata dhe lirinë e të shprehurit në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me bibliotekat dhe profesionin e bibliotekarisë. IFLA/FAIFE e mbikqyrë gjendjen e lirisë intelektuale përbrenda komunitetit bibliotekar anembanë botës, e përkrahë zhvillimin e politikës së IFLA-së dhe bashkëpunimin me organizatat e tjera ndërkombtare për të drejtat njerëzore përgjigjet ndaj shkeljes së qasjes së lirë në informata dhe lirinë e të shprehurit.

UNESCO-ja, OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës e kanë përkrahur misionin edhe financiarisht e edhe me logjistikë. UNESCO-ja, në bashkëpunim të përafërt me administratën civile të UNMIK-ut në Prishtinë, e ka themeluar një kontratë konsultuese me Z. Frederiksen dhe e ka ndihmuar organizimin e misionit në Kosovë. Ngjashëm, Këshilli i Evropës (KE) ka lidhur kontratë me z. Frederiksen dhe zyra e Sekretariatit të KE-së në Prishtinë e ka ndihmuar misionin me sende praktike.

Për më shumë, misioni ka marrë ndihmë praktike prej Shtabit të OSBE-së në Prishtinë dhe ndihmë të madhe financiare prej organizatave bibliotekare në Skandinavi: Bibliotekarforbundet/ Bashkimi i Bibliotekistëve danezë (BF), Bibliotekarforbundet/ Bashkimi i Bibliotekistëve Norvegjezë (BF), Forskeforbundet Fagbibliotekarforening/ Bashkimi i Bibliotekistëve të Veçantë (FBF), Norvegji, dhe Bibliotekarieförbundet/ Shoqata Suedeze Bibliotekare, (BF), Suedi. Këto organizata kanë ofruar fonde për përkthime, interpretime, transport lokal, banim etj.

Për ta përgatitur vlerësimin e situatës që ka të bëjë me arkivat, UNESCO-ja, KE-ja dhe Këshilli Ndërkombëtar për Arkiva (ICA) në dhjetor të 1999-ës organizuan një mission paralel ekspertësh në Kosovë, të cilin e ka zbatuar Z. Bruce Jackson, Arkivist Qarku, Zyja e Regjistratit të Lankashirit, Preston, Mbretëria e Bashkuar. Misioni i Bibliotekave është i bazuar në dhe kushtet dhe përvojat e njëjta që i ka pasur dhe mbledhur z. Jackson.

Misioni i Bibliotekave të Kosovës ka për qëllim t'i mbulojë të gjitha kategoritë e bibliotekave dhe është mbështetur në këto pika:

1. Ta vlerësojë situatën e tanishme të bibliotekave në Kosovë duke e përfshirë vlerësimin e shkatërrimit dhe dëmtimeve të bibliotekave;
2. Ta vlerësojë situatën në fushën e drejtimit të bibliotekave në administrimet ekzistuese;
3. Ta vlerësojë situatën ligjore me drejtimin e bibliotekave;
4. Të këshillojë për masat afatshkurta dhe afatgjata që duhen ndërmarrë për ta siguruar mbulesën e duhur ligjore të bibliotekave dhe çështjeve të lirisë intelektuale; duke e marrë parasysh rëndësinë e bibliotekave si porta vendase kah dijenia, promovimin e qasjes së barabartë dhe reflektimin e pluralitetit dhe llojllojshmërisë së shoqërisë si instrumente për ta përkrahur procesin e demokratizimit;
5. Të këshillojë në përfshirjen e komponentave të drejtimit të bibliotekave në programet e rehabilitimit;
6. Të bëjë rekomandime mbi masat që duhet ndërmarrë për t'i mbrojtur bibliotekat e rrezikuara dhe për ta rindërtuar një sistem funksional të bibliotekave në Kosovë;
7. T'i dorëzojë UNESCO-s, jo më vonë se më 31 mars 2000, një raport të misionit në Kosovë, duke përfshirë:
  - a. Një vlerësim të përgjithshëm për situatën;
  - b. Një plan për veprim të menjëhershëm duke përfshirë rekomandimet për veprim të dërguara UNESCO-së dhe UNMIK-ut;
  - c. Rekomandimet për UNMIK-un që në mënyrë adekuate t'i mbulojë çështjet e bibliotekave në projektet e rindërtimit;
  - d. Një listë të disa projekteve të vogla për përmirësimin e menjëhershëm të situatës;
  - e. Një plan zhvillimi afatmesëm për konsolidimin e situatës;

Ky raport ka përdorur një konvencion që përdoret prej shumë organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë duke i përdorur emërtimet në gjuhët shqipe dhe atë serbe të komunave dhe qyteteve të mëdha kur përmenden për herë të parë, e mandej sipas nevojës. Më vonë në tekst janë përdorur emërtimet në gjuhën shqipe. Për më shumë, emërtimet shqipe janë përdorur për emrat e fshatrave në rajonet ku shumica janë shqiptarë dhe ato serbe në rajonet ku shumica e popullsisë përbëhet nga serbë etnikë.

Vendimi për t'i përdorur emërtimet në gjuhën shqipe si referencë fillestare është bërë pjesërisht për faktin se shumica e hartave të detajuara që i kemi përdorur kanë qenë në gjuhën shqipe (të prodhuara në Shqipëri) dhe pjesërisht për faktin se këto emërtime sot përdoren më së shpeshti. Kjo zgjedhje pra nuk implikon ndonjë pozicionim politik mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, por reflekton një qasje praktike e pragmatike.

Janë disa probleme të përgjithshme gjatë marrjes së informatave në Kosovë, të cilat duhet të përmenden këtu, për shkak se deri në një masë kanë ndikim në gjetjet e misionit. Komunikimi në Kosovë është shumë i vështirë. Edhe pse rajoni është fare i vogël, transporti merr kohë sepse rrugët janë shumë të këqia dhe trafiku shpesh kaotik. Sistemi i telefonave shpesh nuk funksionon fare dhe nuk ka sistem postal. Është gati e pamundur të caktohen takime me njerëz prej jashtë Kosove dhe është vështirë edhe nëse jeni brenda në Kosovë. Në përgjithësi, duhet të vini në takim dhe të shpresoni të keni fat. Ka shumë pak makina fotokopjuese, që do të thotë se është vështirë të mblidhen dokumentacione fizike.

Ndarja në mes të shqiptarëve dhe serbëve e bënë të vështirë vërtetimin e informative, sepse të dyja palët kanë pak njohuri dhe interes për punët jashtë rajoneve të tyre. Njerëzit, të cilët do të kishin mundur të kundershtonin ose vërtetonin nuk janë më. Për më shumë, ka një traditë të kufizuar në punën me statistikën dhe shifrat dhe koncepti i kohës dhe datimit të ngjarjeve bëhet përafërsisht; p.sh., po t'i kishim mbledhur numrat e banorëve ashtu si na janë dhënë në qytete dhe fshatra të ndryshme, atëherë numri i përgjithshëm i banorëve të Kosovës do të na dilte shumë më i madh se që është në të vërtetë.

Si i huaj, gjatë mbledhjes së të dhënave duhet të mbeshtetesh në përkthyes. Të shumtën e rasteve këta nuk janë përkthyes profesionalë, por janë studentë, mësues ose punonjës të institucioneve që kanë ca njohuri të ndonjë gjuhe të huaj. Ndonjëherë këta përkthyes përgjigjen e vet në pyetje dhe ndonjëherë fjalime të gjata lidhur me një çështje rezultojnë me një marrëveshje që tani jepet si përgjegje. Ndërrimi i fakteve dhe tregimeve gjatë bisedës nuk është i pazakonshtëm. Përgjegjet ndonjëherë reflektojnë dëshirën për t'u përshtatur nevojave tuaja ose të donatorëve ose thjesht bëhen për mirësjellje. Po ashtu, duhet marrë parasysh korekta politike dhe agjenda politike vendëse.

Pikat e referencës për misionin tonë kanë qenë shumë ambicioze dhe e kanë përfshirë vlerësimin e të gjitha kategorive të bibliotekave në Kosovë. Për shkaqe praktike - koha e kufizuar që e kishim në Kosovë dhe fakti se ekspertët e tjerë profesionistë e kanë bërë hetimin e arkivave, bibliotekave akademike dhe atyre fetare, na kanë bërë që të përqendrohemi në bibliotekat që shërbejnë publikun në përgjithësi. Për këtë arsye, informatat që janë dhënë në raportin tonë mbështeten në përvojat tona dhe informatat që na i kanë dhënë tjerët. Burimet kryesore janë raportet e ekspertëve si vijojnë:

- *Bibliotekat dhe arkivat në Kosovë*: raport i pasluftës, nga Andras Riedlmayer, Biblioteka e Arteve të Bukura, Universiteti i Harvardit, tetor 1999.
- *Vlerësim i nevojës për libra të dhuruar: Me fokus në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Biblioteka Komunale e Prishtinës*, nga Tania Vitvitsky, Drejtoreshë e Projektit, Fondacioni Sabre, nëntor 1999.
- *Vlerësimi i përgjithshëm i situatës së arkivave në Kosovë*, nga Bruce Jackson dhe Wladyslav Stepniak, Raport i Restriktuar Teknik, UNESCO, janar 2000.

---

### 3. Vlerësim i përgjithshëm i situatës së tashme

Në mars të vitit 2000, veprimet e ndihmës ndërkombëtare në Kosovë kanë levizur prej reagimit urgjent në rehabilitimin dhe zhvillimin afatgjatë, pas nëntë muajsh të operacionit më të madh deri më tash të ndihmës në dollarë të harxhuar për krye banori. Sipas UNHCR-së, përqëndrimi i organizatave humanitare po lëviz në fusha kyçe, si p.sh., nevoja për ta rindërtuar sundimin e së drejtës dhe të çohet përpara toleranca në gjithë Kosovën. Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Çështje Humanitare, Dennis McNamara, e ka aprovuar këtë tranzicion në rindërtim dhe rehabilitim. Në një konferencë shtypi në mars të këtij viti, ai lajmëroi se Sekretari i Përgjithshëm e ka pranuar rekomandimin që shtylla humanitare e UNMIK-ut të shuhet kah mesi i vitit 2000, sepse atëherë nuk do të ketë nevojë për rol humanitar të përmasave të mëdha.

Në sektorin e arsimit, vëmendja është përqendruar në riparimin dhe pajisjen e shkollave dhe në furnizimin me libra. Konzorciumi i teksteve mësimore, që e përfshin UNICEF-in, fondacionin SOROS-in dhe një botues lokal të quajtur Libri Shkollor, është duke e mbikëqyrë shtypjen e librave të ri me fondacione prej disa burimeve qeveritare ndërkombëtare dhe vendore. Për shembull, CIDA e Kanadasë (Organizata Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar) i ka dhënë 1 milion dollarë për këtë qëllim.

Tash për tash, nuk duket të ketë ndonjë përpjekje sistematike për t'u marrë me nevojat e bibliotekave të Kosovës, duke e përfshirë Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare, bibliotekat e fakulteteve brenda Universitetit të Prishtinës si dhe rrjetën e bibliotekave komunale dhe provinciale, e për ato të shkollave as që mund të flitet. Projektet dhe aktivitetet e deritashme janë bërë ad-hoc dhe kanë qenë sporadike, edhe pse disa prej iniciativave më të reja e theksojnë ekzistencën e një rrjeti pune mes bibliotekave dhe koordinimin e gjithmbarshëm.

- Iniciativa e Ndihmës për Internet në Kosovë (KIAI), e administruar nga Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM),

i lidhë organizatat qeveritare amerikane, kompanitë teknologjike, fondacionet, dhe organizatat e ndihmës në një përpjekje të koordinuar për ta përdorë teknologjinë për t'u marrë me nevojat informative dhe humanitare të kosovarëve në periudhën pas konfliktit. Iniciativa e ka bërë Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare me Qendër Informative të Internetit dhe është duke punuar me partnerë të sektorit qeveritar dhe atij privat për t'i koordinuar kontributet dhe dërgimin e librave dhe materialeve të referimit. Një dërgesë e librave është dërguar në Prishtinë në nëntor 1999 dhe më shumë do të dërgohen në të ardhmen. Fondacioni Brother's Brother (Vëllau I Vëllaut), Fondacioni Saber Inc., Scholastic Inc. dhe IDG Books Worldwide (Librat Anëmbanë Botës), do të vazhdojnë të punojnë së bashku për t'i ofruar bibliotekave në Kosovë një llojllojshmëri librash dhe materialeve arsimore. KIAI e ka filluar një proces ku kosovarët mund të vazhdojnë të kërkojnë donacione për libra.

- Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) i ka dhënë një prioritet mjaft të lartë bibliotekave. Disa muaj para luftës, KFOS-i i sugjeroi rektoratit që ta vendosë Intranetin (rrjetë e brendshme) në Universitetin e Prishtinës që do t'i lidhte të gjitha fakultetet, shkollat e larta, Bibliotekën Kombëtare dhe shkollat e tjera. Në kuadër të idesë po ashtu ishte përfshirë ruajtja elektronike e librave dhe materialeve tjera relevante të Bibliotekës Kombëtare dhe bibliotekave të fakulteteve, duke i bërë ato të qasshme nga vende të ndryshme në Universitet dhe përmes Internetit. Një projekt tjetër i KFOS-it, që ende nuk është zbatuar, ravijëzon një rrjet modern bibliotekar, që do t'i lidhte 5 biblioteka komunale me Bibliotekën kombëtare. Projekti do t'i përfshinte komunat e Gjilanit, Besianës (ish-Podujeva), Pejës, Ferizajt dhe Gjakovës, dhe do ta përfshinte trajnimin e 20-30 bibliotekistëve mbi teknologjinë moderne informative.
- Me 2 mars të vitit 2000, prof. Michael Daxner, nga Gjermania, e ka marrë detyrën si administrues ndërkombëtar për sistemin e Universitetit të Prishtinës.

Ministria Austriake e Shkencave ka caktuar z.Robert Stumpf, bibliotekist profesional, që ta kryejë një mision faktgjyftës në Kosovë. Z.Stumpf është caktuar zëvendës i administratorit të ri të UNMIK-ut për Universitetin e Prishtinës, z.Michael Daxner, dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me rindërtimin dhe riorganizimin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

### 3.1 Bibliotekat në Kosovë para luftës

Deri në fillimin e luftërave civile dhe shkatërrimin e Federatës Jugosllave në vitet 1992-1993, çdonjëra nga gjashtë republikat dhe dy krahinat autonome në Jugosllavi kanë pasur biblioteka kombëtare, të cilat i kanë ndërtuar koleksionet e tyre të librave me depozitime ligjore të të gjitha punimeve të botuara në vend. Biblioteka Kombëtare e Kosovës, sikur edhe bibliotekat e secilës prej republikave dhe krahinave tjera, ka pasur përgjegjësi të veçantë për publikimet prej rajonit të vet dhe ato publikime që kanë pasur të bëjnë me atë rajon e që janë publikuar gjetiu. Bibliotekat Kombëtare kanë ofruar informim të plotë mbi të gjitha rrjetat informative në territorin e tyre, duke e marrë rolin e qendrave promovuese të bibliotekave qendrore brenda sistemit dhe janë përkujdesë për trajnimin profesional. Të gjitha bibliotekat kombëtare kanë marrë pjesë në ndërtimin e një katalogu të përbashkët, i cili ndodhet në Internet qysh prej vitit 1988.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës, po ashtu, ka qenë edhe bibliotekë universitare e Universitetit të Prishtinës. Kjo bibliotekë i ka koordinuar aktivitetet e bibliotekave akademike në Kosovë të vendosura në fakultete të ndryshme dhe në institute të ndryshme hulumtuese ose arsimore. Disa biblioteka speciale kanë qenë nëpër institucione industriale, shoqërore, shkencore dhe kulturore, sikur kompanitë e minierave në veri të Mitrovicës, p.sh. Fakulteti i Xehetarisë dhe biblioteka e Ndërmarrjes Xehëtare në Zveçan "Trepça".

Bibliotekat publike kanë ofruar shërbime themelore bibliotekare në komunitetet vendore dhe kanë ofruar mbështetje institucionale për aktivitetet arsimore dhe kulturore. Bibliotekat publike kanë qenë të financuara nga autoritetet vendore, mirëpo me ndihmën e autoriteteve qendrore. Ndiham e tillë është dhënë për blerjen e materialeve dhe pajisjeve për biblioteka dhe kur janë themeluar bibliotekat e reja, kjo zakonisht është bërë me ndihmën e Ministrisë së Kulturës. Koleksionet e bibliotekave publike zakonisht kanë qenë të përbëra prej librave dhe periodikëve të publikuar në vend, derisa librat në gjuhët e huaja zakonisht janë mbledhur vetëm prej bibliotekave akademike, hulumtuese dhe atyre speciale. Shumica e bibliotekave kanë pasur dhe ende kanë grumbuj të mbyllur.

Shumë prej bibliotekave publike në qytetet e mëdha janë gjendur brenda kornizës së Shtëpive lokale të Kulturës dhe në shumë fshatra bibliotekat kanë qenë biblioteka të kombinuara duke e shërbyer edhe publikun e përgjithshëm dhe duke shërbyer si bibliotekë e shkollës. Bibliotekat e shkollave kanë qenë nën juridiksionin e autoriteteve të arsimit dhe secila shkollë fillore dhe e mesme ka qenë e obliguar ta ketë një bibliotekë. Mirëpo, para luftës, një numër i madh i shkollave nuk i kanë pasur bibliotekat e tyre. Statistikat zyrtare tregojnë se në vitin 1989 ka pasur 967 shkolla fillore dhe 69 shkolla të mesme në rajonin e Kosovës dhe vetëm 328 biblioteka shkollore (Figura 1). Shumë pak prej tyre i kanë pasur të themeluara bibliotekat e tyre dhe shumë nxënës janë drejtuar në biblioteka publike për t'i gjetur librat e tyre. Një shumë e madhe e buxhetit të bibliotekave publike është dashur të shpenzohet për blerjen e teksteve shkollore.

Në ish-Jugosllavi çdo republikë dhe krahinë autonome e ka pasur ligjin e vet të bibliotekave. Ligji i Bibliotekave të Kosovës është aprovuar me 28 prill 1978 (KK nr. 630-2/77). Nuk ka pasur ligj të nxjerrë nga niveli federativ për bibliotekat, mirëpo rregulloret, të ashtuquajturat standarde minimale për bibliotekat publike dhe ato akademike, janë adoptuar nga Unioni i atëhershëm i Asociacioneve Bibliotekare të Jugosllavisë. Këto standarde caktonin numrin e punonjësve, numrin e vëllimeve, hapësirën dhe pajisjet, standarde bibliografike për përpunimin e materialeve të bibliotekave etj., për lloj të

veçantë të bibliotekës. Duket se shumë biblioteka nuk i kanë përmbushur standardet, po prapëseprapë janë lejuar të punojnë.

Figura 1.

Bibliotekat në Kosovë para vitit 1999: Numrat dhe vëllimet e librave			
	1989	1992	1995
Bibliotekat hulumtuese dhe të veçanta:	36	31	34
Vëllimet e librave:	927.000	213.000	810.000
Bibliotekat publike:	176	78	59
Vëllimet e librave:	1,927.000	1,859.000	1,080.000
Bibliotekat shkollore:	328	146	144
Vëllimet e librave:	1,224.000	639.000	578.000
Burimi i vitit 1989-ës: Vjetari Statistikor i Jugosllavisë: 1989, Beograd: Instituti Federativ i Statistikës, 1991			
Burimi i vitit 1992 dhe 1995: Vjetari Statistikor i Jugosllavisë: 1999, Beograd: Instituti Federativ i Statistikës, 1999			

Vini re, të dhënat statistikore për bibliotekat janë mbledhur nga Instituti Federativ i Statistikës për çdo tri vjet dhe për këtë shkak intervalet janë trivjeçare. Nuk ka të dhëna mbi punonjësit e bibliotekave.

Figura 2.

Bibliotekat universitare dhe publike në Kosovë prej 1975-1990: Numrat dhe përkatësia etnike		
	1975-1990	1999 deri para luftës
Shqiptare:	107	37
Serbe:	20	37
Të tjera:	17	6
<b>Totali:</b>	<b>144</b>	<b>80</b>
Burimi: UNESCO: rapport de Mission au Kosovo, Ros Borath, 1-30 nëntor, 1999.		

Mospërputhjet në numrin e bibliotekave të regjistruara në mes të figurës 1 e 2 dhe figurës 3 në faqen 16, tregojnë për problemin e përgjithshëm të mbledhjes së të dhënave në Kosovë. Habia vjen prej disa faktorëve. Edhe informatat praktike kanë ngjyrimet nacionale politike dhe implikime etnike dhe ambicie të cilat varen prej fuqisë politike dhe kohërave. Përpilimi i të dhënave është i parregullt dhe bëhet pa kujdes. Gjendja dhe ekzistenca e bibliotekave të tashme është e paqartë dhe definicionet e kategorive të ndryshme të bibliotekave, shkollore, publike ose akademike, janë të paqarta.

### 3.2 Drejtimi dhe administrimi i bibliotekave

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-së, ia beson Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë "kryerjen e veprimeve themelore administruese civile" dhe "organizimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të përkohshme për vetqeverisje demokratike dhe autonome" në Kosovë.

Karakteristikë e trashëgimisë nga sistemi i kaluar administrues është modeli i aktiviteteve të dirigjuara nga shteti, me punonjësit kulturorë të punësuar nga shteti, me privilegjim të madh të trashëgimisë dhe institucioneve serbe dhe, nga ana tjetër, diskriminim të kulturës së shqiptarëve të Kosovës (institucionet kulturore shqiptare e humbën përkrahjen prej shtetit). Të gjithë këta faktorë janë të kombinuar me financim të pamjaftueshëm dhe neglizhencë të tërë sektorit gjatë

dhjetë vjetëve të fundit.

Këshilli Tranzitor i Kosovës është niveli më i lartë i organizimit konsultues të kosovarëve me Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara. Këshilli i Përkohshëm Administrativ (KPA-ja), ka vendosur që 19 departamentet administrative do të bashkadministrohen nga UNMIK-u dhe udhëheqësit politikë kosovarë në të ashtuquajturën SPPS (Struktura e Përbashkët e Përkohshme Administrative). Më 28 shkurt 2000, KPA-ja e ka emëruar znj.Edi Shukriu, kryesuesen e Lidhjes së Gruas, si bashkëdrejtuese të Departamentit të Kulturës. Fatkeqësisht, ne nuk e kemi pasur mundësinë të takohemi me znj.Shukriu dhe bashkëdrejtuesi, z.Gonzalo Retamal Pouilly, ende nuk kishte arritur nga Kili. Lidhja jonë me administratën qendrore të UNMIK-ut është bërë nëpërmjet znj.Sarah Isakson, tash për tash, e vetmja punonjëse e dedikuar për kulturë, dhe z.Tom Koenigs, kryesues i Shtyllës II të Administratës Civile.

Buxheti i UNMIK-ut për bibliotekat publike dhe arkivat për vitin 2000 vlerëson se ka 335 punonjës dhe dedikon shumë prej 1,061.280 DM për pagat e tyre, derisa të mirat dhe shërbimet tjera bëjnë 307.346 DM. Buxheti total i UNMIK-ut për bibliotekat publike dhe arkivat është 1,368.626 DM. Duhet të vihet re se buxheti do të rishikohet kur të ketë të dhëna më të sakta mbi numrin e punonjësve dhe numrin e institucioneve. Totali i buxhetit të UNMIK-ut për kulturë arrin shumë prej 4,650.483 DM dhe përveç arkivave dhe bibliotekave përfshin artet, muzetë, institucionet kulturore dhe sportet (1,000.000 DM).

Punonjësit e bibliotekave ende nuk kanë marrë paga tash e një vit pas mbarimit të luftës. Pagimi i bibliotekistëve dhe i punonjësve tjerë publikë filloi vetëm në mars 2000. Numri i saktë i të punësuarve ende nuk dihet, sepse UNMIK-u nuk ka informata prej disa komunave. Sidoqoftë, shifrat e vërteta duhet të jenë dikund pak më të larta se 335. Vetëm numri i bibliotekave publike ka qenë dikund rreth 180 para vitit 1990 dhe sot vlerësohet të jetë së paku 118, prej të cilave shumica kanë 1 ose 2 të punësuar. Paga mesatare është dikund rreth 250-350 DM në muaj. Sipas një vlerësimi të z.Gërguri, bibliotekat i kanë punësuar dikund rreth 600 bibliotekistë.

### 3.3 Legjislacioni dhe rregulloret lidhur me bibliotekat

Situata me legjislacionin në Kosovë është ende paksa e paqartë dhe administrata e UNMIK-ut ende mundohet ta gjejë rrugën nëpër fushat e ndryshme shoqërore, për ta qartësuar statusin ligjor. Sipas rregulloreve 2000/24 dhe 25 të UNMIK-ut, ligjet që janë zbatuar në Kosovë para shpërbërjes së Parlamentit të Kosovës, në vitin 1989, vlejné ende, derisa të mos zëvendësohen ose ndërrohen me ligje dhe rregullore të reja.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare mban kopje të të gjitha ligjeve që vlejné ose kanë qenë valide në Kosovë. Drejtori, z.Gërguri, na i ka dhënë kopjet e tri teksteve ligjore që kanë të bëjnë me bibliotekat: Ligji mbi bibliotekat, Dekreti mbi Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare dhe Dekreti mbi depozitin ligjor. Natyrisht, këto tekste janë në shqip, kështu që i janë dhënë Departamentit të Kulturës së UNMIK-ut për t'i informuar ata dhe për t'u përkthyer në anglisht. Përkthimet janë dhënë si Aneksat 4, 5 dhe 6 të këtij raporti.

Ligji i tashëm i bibliotekave të Kosovës është pranuar më 28 prill 1978 (KK Nr. 630-2/77). Ky ligj e definojnë aktivitetin bibliotekar si aktivitet shoqëror qëllimi i të cilit është:

"...ta ngrisë nivelin e përgjithshëm të arsimit më anë të librave dhe materialeve tjera bibliotekare; t'i plotësojë në mënyrë të vazhdueshme nevojat kulturore të punëtorëve dhe qytetarëve e, po ashtu, ta zhvillojë punën shkencore dhe profesionale dhe ta zhvillojë ekonominë, arsimin, shkencën, kulturën dhe aktivitetet e tjera" (Neni 1).

Librat dhe materialet tjera janë në "dispozicion të publikut" dhe "punëtorët dhe qytetarët e thjeshtë mund t'i përdorin librat dhe materialet tjera të bibliotekës në mënyrë të barabartë", mirëpo theks i veçantë i jepet rolit të bibliotekave në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Ligji përfshin të gjitha llojet e bibliotekave, edhe pse përqendrohet në bibliotekat e përgjithshme dhe kombëtare (bibliotekat publike dhe shkencore, duke e përfshirë Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare). Ka shumë pak rregullore të veçanta që kanë të bëjnë me bibliotekat speciale dhe ato shkollore. Sipas ligjit, bibliotekat mund të themelohen nga bashkësitë shoqërore dhe politike, bashkësitë me interes kulturor (administratat kulturore vendore), organizatat rajonale dhe organizata tjera nëse plotësohen kushte të caktuara sa i përket financimit, mbledhjes së librave, hapësirës dhe pajisjeve, si dhe punonjësve profesionalë.

Ligji i përkufizon kategoritë e ndryshme të bibliotekave dhe e ravijëzon strukturën e përgjithshme të sistemit bibliotekar të Kosovës. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare është institucioni parësor me përgjegjësi për koordinimin e gjithëmbarshtëm të aktiviteteve bibliotekare, bashkëpunimin e bibliotekave, hulumtimeve profesionale dhe katalogun kryesor, i cili i përfshin të gjitha bibliotekat në Kosovë dhe bibliografinë kryesore, duke i përfshirë materialet e "kombeve dhe kombësive" të Kosovës.

Në nivelin sekondar, ligji definojnë detyrat e bibliotekave kryesore në ofrimin e ndihmës profesionale brenda territorit të tyre, mbikëqyrjen e aktiviteteve bibliotekare, harmonizimin dhe inkurajimin e bashkëpunimit. Autoritetet në nivelin komunal dhe rajonal të kulturës janë përgjegjëse për financimin dhe qeverisjen e bibliotekave lokale dhe atyre të përgjithshme rajonale, derisa autoritetet krahinore për kulturë, arsim dhe shkencë ofrojnë financimin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare. Të

gjitha bibliotekat e përgjithshme janë të obliguara ta kenë statusin dhe bordin. "Në parim", ligji e ofron një shkëmbim dhe huazim të materialeve ndërmjet bibliotekave.

Shumë vëmendje i kushtohet punës korrekte me materiale të bibliotekave, mbajtjes, ruajtjes dhe kufizimit të përdorimit të materialeve me vlerë. Këshilli i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare i merr vendimet përfundimtare mbi rregullimin e materialeve të të gjitha bibliotekave.

Ligji, po ashtu, definon nivelet e arsimit të domosdoshme për bibliotekistët duke i ndarë në pesë kategori të të punësuarve: zyrtar i futjes së të dhënave, zyrtar i lartë i të dhënave, bibliotekist, bibliotekist i lartë dhe këshilltar i bibliotekës. Për t'u bërë bibliotekist duhet diplomë universiteti dhe provim profesional për bibliotekist. Provimet janë mbajtur dhe diplomat janë lëshuar në Universitetin e Beogradit.

Dekreti i Depozitit Ligjor i ka afruar 15 kopje falas të të gjitha botimeve të botuara nga organizatat botuese në Kosovë për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare. Prej këtyre kopjeve, biblioteka duhet t'ia dërgojë nga një secilës prej bibliotekave qendrore (kombëtare) të republikave tjera të ish-RFJ-së, duke i lënë 8 kopje për BKU-në. Për më shumë, Dekreti thotë se të gjitha bibliotekat kryesore (bibliotekat krahinore) janë të obliguara të ofrojnë nga, së paku, një kopje të librave, revistave, broshurave dhe botimeve tjera të botuara në Kosovë me shpenzime të tyre.

Para luftës, sistemet standarde për regjistrimin e materialeve të shtypura, ISSN (Numri Serik Ndërkombtar i Librit/International Standard Book Number), i promovuar nga organizata ndërkombëtare e standardizimit, ISO, është bërë nga zyra qendrore e RFJ-së në Beograd. Shifrat e para në këto kode e identifikojnë vendin në të cilin është bërë publikimi. Ka një dëshirë të fortë që të ketë kod i veçantë për Kosovë dhe të themelohet një zyrë e veçantë e Kosovës që do të merrej me regjistrimet. Tash për tash, librat e ri të Kosovës në gjuhën shqipe nuk regjistrohen sipas standardeve ndërkombëtare.

### 3.4 Shkattërimi dhe dëmet

Në mars 1989, Parlamenti serb miratoi ndryshimet kushtetuese, të cilat ia hoqën Kosovës autonominë, e cila ishte dhënë me Kushtetutën Federative. Ky akt në shumë mënyra ishte pikë kthese në zhvillimin e të drejtave njerëzore dhe politike në Kosovë. Gjatë viteve '90-të, autoritetet serbe gjithnjë e më shumë cenonin të drejtat fundamentale të shumicës shqiptare të Kosovës. Qeveria serbe zbatoi "masat e emergjencës" dhe sistematikisht e shtrëngonte rajonin; regjimi i spastroi të gjitha sektoret e jetës publike dhe e marginalizoi rreth 90% të popullatës.

Më 26 qershor 1990 autoritetet serbe zbatuan një valë të re të dekretëve, zyrtarisht të përshkruara si masa të përkohshme. Këto masa, të cilat mbetën permanente, përshinin përjashtimin nga puna të mijëra punonjësve shtetërorë. Përafërisht 6.0000 mësimdhënës të shkollave u përjashtuan nga puna dhe më shumë pasuan. Profesorët dhe studentët shqiptarë u përjashtuan ose nisën vetë t'i bojkotojnë universitetet, shkollat e mesme dhe ato fillore në vitin 1991, pasi që mësimi në gjuhën shqipe u ndalua dhe u imponua programi uniform serb.

Arsimtarët shqiptarë u përjashtuan nga puna për shkak se refuzuan ta zbatojnë programin e ri serb, ndërsa të tjerët u përjashtuan vetëm pse ishin shqiptarë dhe për shkak të bindjeve të tyre politike. Popullata etnike shqiptare u përgjigj duke e formuar një shoqëri paralele, që e themeloi qeverinë dhe institucionet e saja. Mësimdhënësit, mjekët dhe profesionistët e tjerë ofronin shërbimet e tyre ose prej shtëpive, ose prej ambulancave dhe zyrave të improvizuara. Për shembull, në vitin 1994, burimet shqiptare pohonin se 335, 000 nxënës, të cilët mësonin nga 18, 000 mësimdhënës, vijonin mësimin në sistemin e tyre arsimor paralel.

Z.Mehmet Gërguri, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, është caktuar në këtë pozitë në qershor të vitit 1990. Më pak se katër muaj më vonë, në shtator 1990, Kuvendi i Republikës Socialiste të Serbisë vendosi t'i fusë "masat e dhunshme të përkohshme" në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare. Drejtori u përjashtua dhe një bord drejtorësh prej pesë serbëve dhe malaziasve, si dhe një shqiptari, u caktua në vend të tij. Shqiptari refuzoi ta pranojë emërimin.

Të gjithë shqiptarët që ishin në udhëheqësi u përjashtuan menjëherë nga postet e tyre dhe në fund, 99 bibliotekistë dhe punonjës teknikë - 93 shqiptarë, 3 boshnjakë, 2 turq dhe 1 kroat - u privuan nga e drejta për punë.

Qysh atëherë, z.Gërguri shpesh është përpjekur ta tërheqë vëmendjen e shoqërisë botërore mbi situatën në bibliotekën e tij. Ai i kishte shkruar disa letra UNESCO-s - më 1993, 1995, 1997, dhe më në fund, pas luftës, në vitin 1999, po ashtu, edhe organizatave të tjera ndërkombëtare, duke e përfshirë IFLA-n, por nuk mori asnjë përgjigje.

Helsinki Watch i ka shqyrtuar letrat e përjashtimeve të disa punonjësve shqiptarë të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Arsyeja për përjashtimin e këtyre punëtorëve shpesh përshkruhet - pa ndonjë shpjegim të mëtejshëm - "dështimit të punëtorëve për t'i kryer detyrat e tyre dhe pengimi i punëtorëve të tjerë për përmbushjen e përgjegjësisë dhe punëve të tyre". Në disa raste, përjashtimi arsyetohej me fjalë të tilla: "...gjatë dhënies së deklaratave për shtyp, personi e ka paraqitur rrejtshëm situatën në bibliotekë, e ka informuar gabimisht publikun dhe ka dhënë përshtypje të keqe për punën e organeve të përkohshme [p.sh., ekipet drejtuese emergjente] dhe për veprimet e tyre. Me këtë ajo ai/ajo i ka akuzuar dhe në mënyrë të pasjellshme ka sulmuar punën e tyre dhe masat përkatëse të Parlamentit serb si "metoda policore".



Fleturdhërësa e përjashtimit e cituar më lart mban datën 4 mars 1991 dhe është e nënshkruar nga dr.Slobodan Kostić, i Bordit të Përkohshëm Drejtues. Kostić ishte drejtor i BKU-së prej 1 tetorit 1990 deri në vitet '95-'96. Helsinki Watch i mban kopjet e këtyre fletëpërjashtimeve qysh prej vitit 1990 e këndeje (Ivana Nizich: Jugosllavia: Keqtrajtimi i të drejtave njerëzore në Kosovë 1990-1992, tetor 1992. Helsinki Watch).

Më 1991 Qeveria serbe i intensifikoi politikat asimiluese në Kosovë. Gjuha shqipe u ndalua si gjuhë mësimore në të gjitha nivelet e arsimit. Shumë pak studentë shqiptarë u lejuan të regjistrohen në Universitetin e Prishtinës dhe më mijëra mësimdhënës shqiptarë të Kosovës i humbën vendet e tyre të punës për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Shumë bibliotekistë shqiptarë humbën vendet e punës. Vetëm në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare 99 punonjës të bibliotekës u përjashtuan nga puna dhe nëpunësit shqiptarë të bibliotekës u përjashtuan nga dhomat e leximit.

Rënia e përgjithshme në numrin e bibliotekave e regjistruar në statistikat zyrtare të ish-Jugosllavisë (Fig. 1, në faqen 13) mund të jetë reflektim i këtij zhvillimi politik - përpjekja për ta bërë spastrimin etnik të Kosovës. Deri në një masë kjo mund të reflektojë rezultatin e luftërave të Serbisë me ish shtetet e federatës jugosllave: mbyllja e bibliotekave për shkak të financimit të pamjaftueshëm ose pamundësisë për t'i mbledhur të dhënat e sakta statistikore.

Mirëpo, rënia e numrit të bibliotekave shkollore dhe publike është shumë më e lartë sesa numri i bibliotekave speciale dhe hulumtuese. Kjo tregon se autoritetet serbe ose i kanë mbyllur ato zyrtarisht ose në mënyrë administrative i kanë lënë anash bibliotekat në vendet e banuara me shqiptarë, derisa bibliotekat hulumtuese dhe speciale në qytetet kryesore ishin marrë prej serbëve. Fati i bibliotekave akademike ka qenë ngusht i lidhur me fatin e institucioneve arsimore të Kosovës. Rënia e madhe e vëllimit të librave në Kosovë mund të jetë indikacion për largimin ose shkatërrimin e librave në gjuhën shqipe, derisa rritja në vitin 1995 mund të jetë tregues i furnizimeve të reja me libra në serbisht. Arsyeya e flukseve në numrin e bibliotekave dhe në numrin e vëllimeve të treguara në vjetorët statistikorë të viteve 1989, dhe 1992 dhe 1995, duhet të shikohet më për së afërmi.

Në vjeshtën e vitit 1999 Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, e sponsoruar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, ndërmoi detyrën e evidentimit të gjendjes së të gjitha bibliotekave në Kosovë. Mbledhja e të dhënave u bë në shtator dhe tetor 1999 dhe vështrimi u kompletua në dhjetor. Në janar/shkurt 2000, Zyra e IFLA/FAIFE-së në Kopenhagë e ka pasur tekstin e këtij vështrimi të përkthyer nga shqipja në anglisht. (Aneks 3: Pasqyra e Situatës së Bibliotekave Publike në Kosovë). Teksti i përkthyer është reviduar dhe aprovuar nga z.Mehmet Gërguri, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare.

Figure 3.

Bibliotekat publike të Kosovës para vitit 1990 dhe pas vitit 1999: Numrat dhe vëllimet e librave			
	Para vitit 1990	Pas vitit 1999	Të shkatërruara
Bibliotekat kryesore:	25	22	3
Vëllimet e librave:	843.123	581.431	261.692
Degët e bibliotekave:	158	96	62
Vëllimet e librave:	1.171.505	532.609	638.896
Numri i përgjithshëm:	183	118	65
Vëllimet e librave:	2.014.628	1.114.060	900.588
<b>Burimi:</b> Pasqyrë e situatës në bibliotekat publike në Kosovë. Prishtinë: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.			

Vështrimi përfshin të dhënat për bibliotekat publike në 25 prej 29 komunave të Kosovës. Figura 3 jep të dhënat kryesore të këtij vështrimi. Komunat të cilat nuk janë përfshirë janë Zubin Potoku, Shtërpca, Novobërda dhe Obiliqi. 3 prej këtyre komunave janë komuna ku shumica e banorëve janë serbë e kjo mund të jetë arsyeja që ato nuk janë përfshirë në studim. E katërta, Obiliqi, është një komunë e vogël që kufizohet më atë të Prishtinës, nga perëndimi, për ku është thënë se serbët e kanë djegur bibliotekën kryesore.

Sipas vështrimit, numri i përgjithshëm i bibliotekave publike pas luftës ishte 205 sosh. 183 prej tyre gjenden në pjesët ku tash dominon populli shqiptar dhe 65 janë shkatërruar gjatë periudhës prej prej vitit 1990, deri në përfundim të luftës në

vitin 1999.

Të dhënat e përshkruara në vështrim në përgjithësi janë të konfirmuara nga të dhënat e misionit tonë, edhe pse ka pasur disa mospajtime të vogla. Më kryesorja është që biblioteka e Pejës njëmend e ka mbijetuar luftën, por tash nuk vepron, sepse Shtëpia e Kulturës, ku gjendej biblioteka, është tash venqëndrim i policisë së UNMIK-ut. Librat mbahen të mbyllur në një dhomë në katin e katërt të ndërtesës. Në disa komuna tjera, që i kemi vizituar, kishte dallime të vogla dhe të parëndësishme në numrin e vëllimeve ose në numrin e degëve të bibliotekave. Ndryshimet në këta numra janë pasojë e paqartësisë sa i përket statusit të këtyre bibliotekave, d.m.th., a është dashur të konsiderohen në mënyrë strikte si biblioteka shkollore ose biblioteka të kombinuara.

### 3.5 Akuzat dhe përgjegjësitë e shkatërrimeve

Gjatë verës së vitit 1999, IFLA/FAIFE-ja ka marrë raporte për ndalimin dhe shkatërrimin masiv të literaturës dhe bibliotekave shqiptare, që ka ndodhur gjatë periudhës së pushtetit jugosllav. IFLA/FAIFE-ja po ashtu ka marrë raporte se ende vazhdon shkatërrimi i bibliotekave dhe koleksioneve të librave në Kosovë, mirëpo se tash kanë ndërruar rolet dhe se librat dhe bibliotekat serbe po shkatërrohen prej shqiptarëve. Më 9 qershor 1999, Emisari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së për Ballkanin, Carl Bildt, e përshkroi Kosovën si një "shkretëtitë që duhet të rindërtohet fund e krye". Ai theksoi se kjo do t'i përfshinte rindërtimin e arkivave dhe bibliotekave dhe se ka dëshmi për një shkatërrim masiv të kujtesës kolektive.

Shqiptarët e Kosovës pohojnë se serbët i kanë shkatërruar librat në gjuhën shqipe në mënyrë sistematike në përpjekje për t'a zhdukur trashëgiminë kulturore shqiptare në Kosovë dhe për t'i detyruar shqiptarët ta lëshojnë këtë trevë. Vetëm në Bibliotekën Kombëtare më shumë se 100.000 libra janë shkatërruar në periudhën prej korrikut 1991 deri në vitin 1995. Në korrik 1991, gjashtë kamionë me revista, shumica gazeta, janë dërguar në fabrikën e letrës. Në janar dhe shkurt 1992 rreth 100.000 libra, më shumë se 8.000 revista dhe edhe më shumë gazeta janë nxjerrë jashtë dhe janë dërguar në destinacion të pajohur me kamionë që kishin targa të Nishit në Serbi, dhe me 1995 një numër më i vogël i publikimeve janë dërguar dikund me anije.

Ky proces i "spastrimit etnik" është raportuar edhe në biblioteka të tjera të Kosovës. Se sa bëheshin këto gjëra, varej prej dedikimit të drejtorit të secilës bibliotekë veç e veç për ta kryer këtë veprim. Për shembull, drejtori i tashëm i bibliotekës në Mitrovicë, Hajrullah Mustafa, na informoi se asnjë kësi veprimi nuk ishte ndërmarrë nga drejtoresha e atëhershme Olja Steviç, e cila kishte ikur gjatë ose pas luftës.

Serbët kanë pohuar vazhdimisht se së paku katër biblioteka serbe janë shkatërruar dhe se janë djegur 2 milionë libra në gjuhën serbe. Porosia që po e japim në vijim është dhënë më 28 shtator nga "Glas Javnosti", gazetë serbe, e cila botohet në Beograd dhe shpërndahet nga agjencia e lajmeve "Tanjug" dhe nga Manastiri i Deçanit. Porosia mbante titullin "Goethe, Shakespeare digjen... Terroristët shqiptarë i kanë djegur më shumë se 2 milionë libra në gjuhën serbe në Kosovë":

"Prej arritjes së KFOR-it, terroristët shqiptarë shkatërruan në bibliotekat vendore në Kosovë më shumë se 2 milionë libra në gjuhën serbe", thonë përfqësuesit e arkivit historik në Mitrovicë. Po ashtu, në shenjestër është edhe materiali shumë i rëndësishëm i arkivave. Këto shkatërrime janë bërë para syve të KFOR-it dhe asgjë nuk është bërë që të mbrohen librat në gjuhën serbe në biblioteka dhe nëpër institucione të tjera serbe në Kosovë. Është turp që veprat e Goethe-s, Shakespear-it e të tjerëve digjen ndër sytë e ushtarëve të KFOR-it, të cilët vijnë nga vendet e këtyre shkrimtarëve. Në pozitën më të keqe janë bibliotekat komunale në Prizren, Gjakovë, Istog, Glogovc, Skënderaj, Podujevë dhe vende të tjera, të cilat janë nën kontrollin e pjesëtarëve të UÇK-së. Ky lloj barbarizmi nuk mbahet mend prej kohës së Hitlerit dhe djegies së librave nga nacistët gjatë Luftës së Dytë Botërore".

Shihet qartazi se qëllimi është që faji për shkatërrimin e librave t'u vihet shqiptarëve që tash e kontrollonin këtë trevë, mirëpo kur vjen puna të dhënia e fakteve këto pohime nuk gjejnë ndonjë bazë.

Pikësëpari, kurrë nuk ka pasur dy milionë libra në gjuhën serbe në bibliotekat e Kosovës, as simbas statistikave zyrtare jugosllave (shih Fig. 1), E dyta, shumica e bibliotekave të përmendura në Prizren, Gjakovë, Istog, Glogovc dhe Skënderaj janë në pjesën perëndimore të Kosovës, ku vet serbët kanë qenë përgjegjës për djegien e qyteteve dhe katundeve. Shumica e shkatërrimeve të librave dhe të ndërtesave të bibliotekave në këtë rajon është bërë në katunde. Bibliotekat kryesore e Istogut, Glogovcit, Skënderajt dhe Podujevës, që gjenden në pjesën lindore të Kosovës, janë djegur ose shkatërruar, derisa ky nuk ka qenë rasti me bibliotekat e Prizrenit dhe Gjakovës. Në bibliotekat e mbijetuara të Prizrenit dhe Gjakovës koleksionet e librave janë të paprekura dhe librat në gjuhën serbe ende gjenden nëpër raftë. Përfundimisht, është interesante të vërehet se vet serbët i definojnë bibliotekat publike në Kosovë si "institucione kulturore serbe", duke i lënë anash 80-90% të popullsisë së kësaj treve.

Një vështrim më i detajuar i shkatërrimit të supozuar të bibliotekave dhe librave nga ana e shqiptarëve është shprehëdarë nën titullin: "Ekstremistët shqiptarë djegin librat serbë". Ky artikull është shprehëdarë nga "Tanjug"-u, gazeta "Dnevna Borba" dhe egroups-i i Deçanit (<http://www.egroups.com/message/decani/23410>), më 20 dhjetor 1999. Më së shumti citohet ish-drejtori serb i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, z.Jordan Ristic, i cili ishte drejtor në vitet 1995/96 e deri më 16 qershor 1999:

"Qysh prej ardhjes së forcave ndërkombëtare të KFOR-it, në Krahinën e Kosovës dhe Metohisë të Serbisë, në qershor, të gjithë punonjësit serbë janë përjashtuar nga Biblioteka Kombëtare 'Ivo Andriç' e Universitetit të Prishtinës, e tash serbët edhe nuk lejohen të hyjnë në këtë bibliotekë që është më e madhja në krahinë" - i tha drejtori Jordan Ristiç Agjencisë së Lajmeve "Tanjug", të shtunën.

Duke shprehur brengosje të madhe për tërë fondin e bibliotekave të Krahinës, Ristiç tha se, "dëshmitarët kishin parë vandalët shqiptarë duke i djegur ose shkatërruar librat në ndonjë mënyrë tjetër e duke i hedhur mandej në kontejnerë mbeturinash, para syve të pjesëtarëve të KFOR-it. Ekstremistët shqiptarë, po ashtu, i kishin vënë flakën Bibliotekës së Qytetit në Prishtinë, që ka qenë biblioteka më e madhe në krahinë, me rreth 400.000 tituj. Përveç librave në gjuhën serbet, djegia, po ashtu, shkatërroi libra në shqip e turqisht dhe libra të tjerë në gjuhët e grupeve të tjera etnike." - tha Ristiç. "Tash për tash, është vështirë të merren informata të besueshme për fatin e një milion librave në Bibliotekën Kombëtare e Universitare dhe nuk është i mundshëm komunikimi me ata që kanë hyrë në këtë ndërtesë pas përjashtimit të serbëve." - thotë Ristic. "Në kohën e ndjekjes së serbëve, biblioteka ishte nikoqire e dy ekspozitave – 'Kishat e drunjtat të Serbisë' dhe 'Miniaturat e Hilandarit' – bëri të ditur Ristiç. "Asgjë nuk dihet as për këto ekspozita." - tha ai.

"Gjatë jetës së saj të gjatë dhe të pasur shkencore, biblioteka ka qenë qendër specifike kulturore, në të cilën organizoheshin mbi njëqind ngjarje kulturore për çdo vit, prej koncerteve dhe ekspozitave të pikturave deri te panairt e librave dhe simpoziumet në të cilat vinin figura të njohura nga vendi dhe e mbarë bota.

Biblioteka, po ashtu, botonte nga 30 tituj librash çdo vit, prej të cilave më e njohura është monografia mbi Manastirin e Graçanicës, libri mbi Drenicën dhe tre libra nga patriarku ortodoks serb Pavle.

Më herët, para tërëhijës së shqiptarëve të Kosovës nga jeta publike, për shkak të shtypjes që u bëhej nga udhëheqësit e tyre ekstremistë dhe terroristë, biblioteka po ashtu kishte qenë nikoqire e të gjitha ngjarjeve më të rëndësishme në gjuhën shqipe. Asgjë nuk dihet as për fatin e fondeve të librave të Universitetit të Prishtinës.", tha Ristiç. "Serbët e përzënë nga disa pjesë të krahinës i kishin thënë atij se i kishin parë shqiptarët e Kosovës duke i nxjerrë librat nga shtëpitë dhe banesat serbe dhe duke i djegur publikisht në rrugë."

"Po ashtu, është konfirmuar se terroristët e pakontrolluar shqiptarë i shkatërruan të gjitha bibliotekat e shtëpive private, posaçërisht prej shtëpive të shkrimtarëve të shquar që kishin jetuar në krahinë." Vetë Ristiçi ishte pronar krenar i njërit prej koleksioneve më të mëdha në Kosovë - përmby 4.500 tituj. Gjithë këta libra janë shkatërruar. Ristiçi është përzënë nga banesa e tij, nën kërcënim të armëve. "Shtresa e tretë e qiraxhinjve të tij" i kishin telefonuar për t'i thënë se biblioteka e tij private tash "përbëhej vetëm prej parketit" - tha ai. "Nuk dihet asgjë për fatin e librave në rajonin e Prizrenit, Kosovës dhe Metohisë Jugperendimor, prej nga janë dëbuar pothuajse të gjithë serbët. Kjo e përfshin bibliotekën e Fakultetit Teologjik të Prizrenit, me njërin prej arkivave më të pasura shpirtërore të rajonit. Serbët të cilët kanë ikur nga Prizreni thanë se ndërtesa e këtij fakulteti ishte plaçkitur dhe djegur pjesërisht, kështu që mund të supozohet se çka ka ndodhur më librat në të." - tha Ristiç."

Koha kur është dhënë ky lajm është e jashtëzakonshme. 20 dhjetori i vitit 1999 rastis të jetë vetëm disa ditë pas lëshimit të gjetjeve madhore të studimit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, e cila i akuzonte serbët për shkatërrimin e bibliotekave. Më tutje, artikulli në disa vende implikon se ende nuk është bërë një vështrim i plotë mbi situatën. Më shumë se gjashtë muaj pas luftës, vetëm supozohet se çka mund t'i ketë ndodhë 'njëres prej arkivave më të pasura shpirtërore të rajonit'. Në Fakultetin Teologjik në Prizren ose më mirë thënë në Bibliotekën Seminare dhe Teologjike të Kishës Ortodokse Serbe në Prizren. Sipas Andreas Riedlmayer-it, kjo ndërtesë është e paprekur dhe e ruajtur për së afërmi prej ushtarëve të KFOR-it gjerman. Që prej perfundimit të luftës në qershor 1999, Seminari ka shërbyer si vendstrehim për refugjatët serbë, romë, turq dhe shqiptarë. Nuk kemi gjetur asnjë burim serb i cili pohon se janë shkatërruar librat nga kjo bibliotekë.

Biblioteka e Qytetit në Prishtinë nuk është djegur dhe shifrat e librave prapë janë të tepruara dhe të pasakta. Qendra për Paqe dhe Tolerancë në Bograd ka ofruar raporte prej burimeve në Prishtinë për sulmet dhe keqtrajtimin e serbëve etnikë në Kosovë prej 18 qershorit deri më 2 shtator 1999, duke i përfshirë raportet e hollësishme të vjedhjeve ose marrjes së banesave (<http://www.cptkosovo.org.yu/English/>). Ky burim serb përmend vetëm një bibliotekë gjatë kësaj periudhe. Më 28 qershor raporti thotë se: "Biblioteka publike në Prishtinë është okupuar me forcë dhe është vjedhur vetura, 'Shkoda Felicia', me tabelë regjistrimi: PR 104 11, ngjyrë të kaltër të mbyllët metalike, te rruga "Kralj Milutini", nr. 10". Nuk përmenden biblioteka ose libra të shkatërruar në Prishtinë ose gjëkund tjetër në Kosovë, edhe pse janë dhënë shumë akte të tjera dhune.

Artikulli pohon se të gjithë punonjësit serbë janë përjashtuar nga puna në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare. Z. Gërguri na informoi se punonjësve të etnicitetit serb u është ofruar kthimi në punët e tyre, por asnjëri nuk e kishte pranuar këtë ofertë. Disa biblioteka në rajon na lajmëruan se u kanë ofruar disa punonjësve serbë të kthehen në punët e tyre, e disa edhe ishin paraqitur për të vepruar ashtu. Mirëpo asnjëri nuk kishte filluar shërbimin. Frika për sigurinë personale duket të jetë shkaku kryesor i kësaj.

Artikulli qartazi duket të jetë prodhuar për qëllime propagandistike si kundërpërgjigje akuzave të bëra nga ana shqiptare. Informatat që jepen në të janë fare qartë të pavërteta dhe intervista duket të jetë e vjetruar duke e reflektuar konfuzionin e

ditëve të pas luftës dhe pa njohuri mbi situatën në kohën që ishte publikuar (dhjetor 1999).

Është e pamundur të përjashtohet mundësia që disa biblioteka të jenë shkatërruar nga ana e shqiptarëve, që i kishin "sulmuar institucionet kulturore serbe". Në të vërtetë, në disa prej rajoneve më të shkatërruara, si në Rahovec, librat në gjuhën serbe ishin të vetmit që kishin mbetur në biblioteka.

Përfaqësuesit e pothuajse të gjitha bibliotekave që i vizitoi misioni ynë pohuan se ende kanë libra në gjuhën serbe dhe kontrollet josistematike që i kemi bërë nëpër raftet e bibliotekave e konfirmojnë këtë. Z.Hajrullah Mustafa, drejtori i Bibliotekës Komunale në Mitrovicë, tha: "Duhet t'i mbajmë të gjitha librat, pa marrë parasysh se në cilën gjuhë janë". Edhe pse këta libra thuajse nuk janë më të vlefshëm për shfytëzuesit, ende mbahen dhe ruhen.

### 3.6 Bashkëpunimi dhe perspektiva e pajtimit

Sot, nuk ka bashkëpunim e as edhe kontakte në mes të profesionistëve të shumicës shqiptare dhe profesionistëve në enklavat etnike serbe. Kemi hasur vetëm në një rast të përpjekjes së njëfarëloj bashkëpunimi. Drejtori i Bibliotekës kryesore në Prishtinë, "Hivzi Sulejmani" na informoi se ka pasur një bisedë me një bibliotekist serb në Fushë-Kosovë. Z.Pireva kishte propozuar që të bëhet një ndërrim librash - librat në serbisht për librat në shqip, dhe anasjelltas, mirëpo asgjë nuk kishte dalë nga kjo dhe nuk ka pasur kontakte të mëtejme.

E kemi diskutuar çështjen e bashkëpunimit me disa bibliotekistë shqiptarë. Asnjëri prej tyre nuk e hodhi poshtë idenë e bashkëpunimit, mirëpo të gjithë thanë se kishte me qenë e pamundur, sepse ata nuk mundën, ose më mirë e thënë, nuk guxojnë të shkojnë në enklavat serbe. Kur udhëtuam që ta vizitojmë enklavën më të madhe serbe, z.Jetish Kadishani, i cili është përgjegjës për kontaktet me bibliotekat publike në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare, erdhi me neve. Z.Kadishani nuk guxoi të hynte me ne në brendë të enklavës, edhe pse ne ishim duke e ngarë veturën e KB-së, kështu që ai qëndroi në bibliotekën kryesore në Mitrovicë. Më vonë na informuan se ai ishte munduar që nëpërmjet neve t'ia përcjellë një porosi bibliotekistëve në Leposaviq. Z.Kadishani nuk e flet asnjë gjuhë të huaj, kështu që i ishte lutur një vozitësi të KB-së, serb i cili e flet anglishten, të na pyes se a mund të ofrojmë ndonjë bashkëpunim. Vozitësi nuk na e kishte thënë këtë. Arsyeja për këtë mund të jetë se oferta ka qenë e varur prej pranimi të Republikës së Kosovës.

Ne, po ashtu, e pyetëm drejtorin e Bibliotekës Publike në Leposaviq, z.Milomir Tanaskoviç, nëse do të ishte i interesuar për bashkëpunim me ndonjë bibliotekë publike në Mitrovicë, që gjenden në pjesën jugore. Ai na tha se do të ishte i interesuar të bëjë kontakte edhe me Mitrovicën e edhe me Prishtinën, por se nuk i njihnte njerëzit përgjegjës në ato vende, dhe se dyshonte se pozita e tyre ishin legjitime. Në anën tjetër, biblioteka e tij ishte e izoluar dhe nuk kishte kontakte me bibliotekat në Serbi - edhe pse biblioteka i kishte të gjitha gazetat ditore të Serbisë po atë ditë që ishin shtypur. Ai tha: "Nëse futem në një bashkëpunim të tillë, do të isha i pari që e bëjë këtë - në cilëndo fushë."

Përshtypja e përgjithshme gjatë misionit tonë ishte se mundësitë e tashme për bashkëpunim dhe pajtim janë shumë të kufizuara. Duket se problemet vijnë për shkak të situatës së gjithëmbarshe politike në Kosovë dhe jo aq shumë për shkak të konflikteve personale ose profesionale. Shumë njerëz me të cilët biseduam linin të nënkuptohej se bashkëpunimi do të mund t'u shkaktonte probleme me njerëzit e tyre. Z.Sulejmani, drejtori i Bibliotekës Komunale të Prishtinës, na e tha një thënie karakteristike për relacionin midis profesionistëve bibliotekistë serbë e shqiptarë: "Nëse tregojnë interesim dhe na kontaktojnë, atëherë është në rregull".

---

## 4. Vlerësimi i veçantë i institucioneve dhe sektoreve

Gjatë dymbëdhjetë ditëve të qëndrimit tonë në Kosovë, ishim në gjendje t'i vizitojmë të gjitha rajonet e pesë rrethëve të Kosovës, të gjitha qytetet e mëdha dhe 13 prej 19 komunave, duke e përfshirë Leposaviqin, enklavën më të madhe serbe në Kosovë.

I kemi vizituar më shumë se 20 biblioteka dhe institucione të tjera kulturore dhe kemi pasur takime zyrtare me UNMIK-un dhe 4 organizata të tjera ndërkombëtare të rëndësishme. Kemi bërë intervista profesionale dhe kemi biseduar me më shumë se 45 persona - dhe kemi takuar qindra punonjës kulturorë e bibliotekistë të Kosovës. Informatat e dhëna në këtë pjesë të raportit tonë janë të bazuara në përvojat tona dhe janë të plotësuara me burime të tjera të cilave u referohemi në tekst.

Figura 4. Harta e Kosovës që përmban rrethet dhe komunat. Emërtimet e vendbanimeve janë në gjuhën serbe.



#### 4.1 Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka filluar, si Biblioteka Rajonale e formuar në Prizren në vitin 1944 (1944-1963) dhe më vonë si Biblioteka Krahinore (1963-1970). Kur është themeluar Universiteti, në vitin 1970, Biblioteka, po ashtu, mori funksionin dhe emërtimin si Biblioteka Kombëtare dhe Universitare.

Ndërtimi i ndërtesës së tashme, që gjendet në qendër të Prishtinës, filloi me 1974 dhe biblioteka e re u inaugurua me 25 nëntor 1982. U ndërtua me një stil i cili lidh së bashku format arkitekturale të stilit bizantin dhe atij islam. Fondi i librave të bibliotekës në vitin 1983 përbante 600.000 libra. Ndërtesa shtatënivelëshe, me 12.000 metra katrorë të sipërfaqes së përdorshme, ka dy dhoma leximi me 300 dhe 100 ulëse, respektivisht, një dhomë leximi të periodikëve, dhomat për koleksionet e veçanta, katalogje dhe hulumtime. Amfiteatrin me 150 ulëse dhe sallën e takimeve me 750 ulëse. Kapaciteti mbajtës i saj është 2 milion libra. Librat mbahen në dy nivele përfundi përdhësës dhe janë të mbyllura për publikun, që është praktikë e zakonshme për këtë rajon.

Biblioteka funksionon si depozituese ligjore e të gjitha materialeve të botuara në Kosovë. Në bazë të ligjit depozitues biblioteka ka marrë 8 kopje të të gjitha botimeve në Kosovë dhe nga një kopje të të gjitha botimeve të botura në republikat tjera në Jugosllavi me anë të ndërrimeve me Bibliotekat e tjera Kombëtare. Z.Gërguri shpreson t'i zgjerojë fondet e bibliotekës me të gjitha botimet në gjuhën shqipe që botohen në Perendim "çdo gjë që shkruhet në shqip". Kjo bëhet në Kroaci, për shembull, ku Biblioteka Kombëtare mbledh "Croatica-në" dhe në Slloveni ku Biblioteka Kombëtare mbledh "Slovenica"-në, me ndërrime me bibliotekat e tjera dhe/ose duke blerë libra.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e ka nërmend ta rinisë detyrën e botimit të bibliografisë kombëtare. Me z.Gërguri e diskutuam çështjen e bibliografisë "Albanica" përballë një tjetre e cila do t'i përfshinte të gjitha botimet në Kosovë, duke i përfshirë edhe ato serbe - dhe botimet në gjuhët tjera. Ligji i tashëm mbi bibliotekat qartazi përfshikon se BKU-ja: "Bën bibliografinë e azhurnuar dhe retrospektive të materialeve librare të të gjitha kombeve dhe kombësive të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës".

Deri në vitin 1990/'91, Biblioteka ka qenë e lidhur me katalog Interneti me të gjitha bibliotekat tjera në Jugosllavinë e atëherëshme me anë të një datoteke të përbashkët bibliografike të instaluar në një kompjuter nikoqir në Maribor të Sllovenisë. Momentalisht, lexuesve u ofrohet vetëm një katalog i shtypur. Kompjuteri i vjetër i 1980, me të cilin hyhej në katalog, ende gjendet në bodrum dhe nuk është e qartë nëse ekzistojnë shirita ndihmës të të dhënave. Drejtori i bibliotekës shpreson se të dhënat që gjenden në këtë kompjuter do të barten në sistemin e ri kompjuterik.

Edhe pse shumë e lënë pas dore, ndërtesa është e paprekur, përpos disa dëmtimeve të vogla në pjesën e hyrjes kryesore. Biblioteka është e pajisur me sisteme automatike për porositjen dhe arritjen e librave, por momentalisht nuk punojnë as shiriti për bartjen e librave e as ashensorët e ndërtesës. Bibliotekistët i bartin librat prej bodrumit në dhomat e leximit, në dorë. Si çdokund tjetër në Prishtinë, rryma elektrike ndërpritet shpesh dhe nuk ka nxemje.

Problem i madh është depërtimi i ujit në disa nivele të poshtme të ndërtesës. Ka ujë në dysheme dhe disa raftë të librave tashmë kanë filluar të ndryshken. Vendi ku është ndërtuar ka rënie, dhe kur është ndërtuar ndërtesa, është instaluar pompa për heqjen e ujit. Mirëpo, me ndërprerjet e shpeshta të rrymës elektrike dhe me heqjen e gjenaratorit ndihmës, situata është keqësuar shpejtë. Fondi i librave përballët me një rrezik të madh dhe dështimi për ta restauruar pompimin e ujit do të krijojë probleme të mëdha, për shkak të nevojës së zëvendësimit të rafteve dhe pajisjeve të tjera.

Edhe pse më shumë se 100.000 libra janë larguar, koleksioni kryesor i seksionit hulumtues të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare ka shpëtuar thuajse i paprekur. Mirëpo Brenda 10 vjetësh vetëm 22.000 libra i janë shtuar koleksionit, asnjë prej tyre në gjuhën shqipe. Qysh prej përfundimit të luftës nuk ka pasur të holla për të blerë libra të tjerë, për t'i kompenzuar vitet e humbura.

Sipas z.Bruce Jackson, Manuskripti Oriental dhe Koleksioni i shtypur në gjuhën shqipe janë posaçërisht të dëmtuar. Pasi që dokumentacioni nuk ka qenë i kompletuar në vitin 1990. Është vështirë të jepen informata precize për dëmet e bëra. Manuskriptet tash mbahen të gjitha në një dhomë dhe janë në gjendje të keqe.

Para vitit 1991, BKU-ja i ka kryer veprimet e veta me anë të 11 departamenteve administruese, me 139 bibliotekistë dhe punonjës të tjerë teknikë. Sot, biblioteka ka 70 punonjës, rreth 50 bibliotekistë dhe 20-22 punonjës teknikë. Gjatë shkurtit/marsit të vitit 2000 do të punësohen edhe 10 njerëz të tjerë. Na kanë iformuar se përparësi do të kenë profesionistët e rinjë. Sipas z.Gërguri, biblioteka ka pasë rreth 10.000 shfrytëzues të regjistruar për çdo vjet dhe përafërsisht 1.000 shfrytëzues ditor. Sot, ky numër ka rënë shumë. Edhe pse biblioteka është e hapur për studentët, mungesa e rrymës elektrike detyron mbylljen e hershme e po ashtu mungesa e nxemjes e kufizon shfrytëzimin. Gjërat mund të përmirësohen kur të vijnë pranvera dhe vera, por shumë studentë e kanë lënë Universitetin për të punuar me OJQ-të dhe organizata tjera ndërkombëtare. Një strip vendës paraqet dy vetë që takohen në rrugë, e njëri i thotë tjetrit: "A ke dëgjuar që e kanë mbyllë Universitetin?" - "Jo, pse?" - "Nuk ka më studentë e profesorë. Të gjithë po punojnë me ndërkombëtarët".

Rreth 150 shirita të "Kosova-Filmit" janë gjetur në dysheme. Nuk dihet se a ishin të caktuar për t'u ruajtur, por na kanë thënë se tash mbahen në raftë për ta zvogëluar mundësinë e dëmtimit. Janë bërë disa iniciativa ndërkombëtare për ta përkrahur bibliotekën. Tania Vivitsky, drejtoreshë projekti ne Fondacionin Sabre, ishte në Prishtinë, në tetor 1999, për një vizitë vlerësimi dhe është duke punuar me organizata të donatorëve dhe me botues për ta themeluar një program të donacioneve të librave. Fondacioni Soros ia ka ofruar bibliotekës qasjen në datotekën e Internetit të EBSCO-së, që mban përafërsisht 4.500 periodikë. Pasi që, nuk ka shërbim postar ndërkombëtar në Kosovë, postimi i parapagimeve të revistave nuk mund të bëhet, mirepo qasja elektronike dhe mundësia e shtypjes së materialeve janë arritje të mëdha në shërbimet përdoruese. Biblioteka tash është duke u munduar që t'i rithemelojë lidhjet me profesionistët të bibliotekave jashtë Kosovës. Z.Gërguri na ka informuar se 10 bibliotekistë kosovarë, 6 prej BKU-së, një nga Vushtrria, një nga Mitrovica, një nga Gllogovci dhe një nga Skënderaj, do të shkojnë në një konferencë në Kroaci me 26 dhe 27 prill të këtij viti. Për më shumë, BKU-ja e ka nënshkruar një marrëveshje me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë për bashkëpunim në të ardhmen, duke e përfshirë shkëmbimin e nga dy kopjeve të secilit material të shtypur në gjuhën shqipe dhe të të dhënave bibliografike.

Problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Biblioteka Kombëtare dhe Universitare në këtë moment janë:

- Pajisjet e zhdukura, të dëmtuara ose të vjetruara:
  - Sigurimi i gjeneratorit për ta vënë në veprim pompën për t'i ndalur problemet madhore që do të kushtonin shumë;
  - Ndrejja e furnizimit me rrymë elektrike;
  - Ndrejjet e sistemit të bartjes së librave dhe ashensorëve;
  - Sigurimi i pajisjeve për zyrë;
  - Sigurimi i lidhjeve telefonike;
- Nevoja për ta kompenzuar një dekadë të lënies pas dore të pasurimit të koleksioneve;

- Zëvendësimi i teksteve në gjuhën shqipe të shkatërruara në vitet 1990 (mundësisht me anë të kontakteve me bibliotekat tjera të ish Jugosllavisë);
- Sigurimi i teksteve moderne mësimore për studentët;
- Sigurimi i librave të reja në gjuhën angleze, me këtë listë të përparësive: Mjekësore, Inxhinieri, Shkencë kompjuterike, referencë (fjalorë dhe enciklopedi) Biznes/ekonomi, Drejtësi, Art/muzikë, Xehëtari (thëngjill, ar, argjend) dhe Gjuhë angleze;
- Nevoja për masa konservuese dhe ruajtëse:
  - Zhvendosja e dorëshkrimeve në vende të sigurta e të kontrolluara;
  - Programi i ruajtjes, me trajnim të mundshëm në Itali;
  - Sigurimi i materialeve konzervuese dhe i pajisjeve së bashku me rifillimin e konzervimit në Arkivat e Kosovës;
- Katalogjet në Internet dhe sistemeve të automatizuara:
  - Sistem i ri automatik;
  - Rikonvertimi i katalogut digjital;
- Nevoja për trajnim profesional:
  - Kurse të shkurtëra dhe grupe pune për punonjës të bibliotekave të organizuara nga ekspertë vizitues.

#### 4.2 Bibliotekat akademike dhe ato të fakulteteve

Universiteti i Prishtinës ka 7 shkolla të larta (Shkolla të larta të mësimdhënësve dhe për trajnim teknik) dhe 13 fakultete. Shkolla e lartë është kolegji dyvjeçar i nivelit universitar. Këto shkolla zakonisht janë shkolla të trajnimit të mësimdhënësve, të biznesit ose inxhinierisë.

Shkollat e larta janë: 1) Shkolla e Lartë për Trajnimin e Mësimdhënësve, Prishtinë; 2) Shkolla e Lartë për Trajnimin e Mësimdhënësve, Prizren 3) Shkolla e Lartë për Trajnimin e Mësimdhënësve, Gjakovë; 4) Shkolla e Lartë për Trajnimin e Mësimdhënësve, Gjilan; 5) Shkolla e Lartë e Ekonomisë, Pejë; 6) Shkolla e Lartë e Inxhinierisë, Ferizaj dhe 7) Shkolla e Lartë e Inxhinierisë, Mitrovicë.

Fakultetet janë: 1) Fakulteti Filozofik, Prishtinë; 2) Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë; 3) Fakulteti i Shkencave Matematiko-natyrore, Prishtinë; 4) Fakulteti Juridik, Prishtinë; 5) Fakulteti Ekonomik, Prishtinë; 6) Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Prishtinë 7) Fakulteti i Elektroteknikës, Prishtinë 8) Fakulteti i Makinerisë, Prishtinë; 9) Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë 10) Fakulteti i Arteve, Prishtinë; 11) Fakulteti i Xehëtarisë dhe Metalurgjisë, Mitrovicë; 12) Fakulteti i Edukatës Fizike, Prishtinë dhe 13) Fakulteti i Bujqësisë, Prishtinë.

Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore përfshin 5 biblioteka ose koleksione të librave që gjenden në ndërtesa dhe departamente të ndryshme. Të gjitha këto janë plaçkitur dhe u duhen libra, revista dhe kompjutorë që ofrojnë qasje në Internet dhe në datoteka. Fakulteti i Filologjisë po ashtu raporton se i janë plaçkitur shumë libra në shqip dhe në gjuhë të huaja. Fakulteti i Ekonomisë raporton se i është plaçkitur biblioteka me më shumë se 20.000 libra në të tri gjuhët. Ka nevojë për pajisje të bibliotekave, literaturë profesionale dhe revista shkencore.

Në bibliotekën e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës është raportuar se janë marrë pothuajse të gjitha librat. Në Fakultetin Juridik janë vjedhur shumë pajisje teknike, nxemëse, telefona, kompjutër etj, dhe janë shkatërruar disa libra dhe disa kompjuterë. I është ndërruar vendi tërë fondit të librave dhe krejtë inventarit të bibliotekës. Vëllimi prej 100.000 librave më vonë është gjetur nga KFOR-i i hedhur gjuajtur në disa lokacione përreth Prishtinës, të përgatitur për transport dhe të futura në kuti kartoni me mbishkrimin "biblioteka" në alfabetin cirilik. Biblioteka e Fakultetit Juridik ka nevojë për literaturë moderne juridike, si dhe nga shkenca të tjera; pajisje elektronike, kompjutorë e të ngjashme.

KFOS-i është duke marrë pjesë në një projekt i cili ofron literaturë themelore për Universitete. Projekti synon t'i ketë 40 tituj themelore të fushave të ndryshme të specializuara të përkthyer në gjuhën shqipe. Titujt janë zgjedhur në bazë të kërkesave dhe sugjerimeve nga fakultetet e Universitetit.

Ne e vizituam bibliotekën e Shkollës së Lartë për Trajnimin e Mësimdhënësve ose Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjilan, e cila nuk ishte dëmtuar gjatë luftës. Biblioteka ka 50.000 libra të cilat janë të paprekura, por koleksioni vuan prej mungesës së ripërtirjes gjatë dekadës së fundit. Dhomat e pajisjet janë relativisht të mira duke përfshirë një dhomë leximi me rreth 30 ulëse.

#### 4.3 Bibliotekat publike

#### 4.3.1 Rrethi i Prishtinës:

Prishtina, Podujeva, Glogovci, Obiliqi, Fushë-Kosova, Lipjani, Shtimja

*Rajoni i Prishtinës është më i madhi edhe në aspektin e shtrirjes gjeografike e edhe për nga numri i banorëve dhe përmban kryeqytetin e Kosovës. Gjendet në pjesën qendrore dhe lindore të Kosovës dhe kufizohet me Republikën Federative të Jugosllavisë, të Serbisë në verilindje.*

#### Bibliotekat komunale të Prishtinës

Komuna e Prishtinës ka 17 biblioteka publike, ate kryesoren në Prishtinë dhe 16 biblioteka degë në dhe rreth Prishtinës: Pallati i Rinisë, biblioteka e "Përrallave", biblioteka letrare e shkollave, Hade, Mramor, Kaqikollë, Jugoviq, Barilevë, Llukar, Koliq, Hajvali, Llapla Sellë, Graçanicë, Çagllavicë, Slivovë dhe Viti të Marecit. Biblioteka kryesore e qytetit ka pasur rreth 58.475 libra dhe 16 bibliotekat degë kanë pasë 108.541 libra, gjithsejt 167.016 libra. "Dora e Zezë" serbe i ka djegur bibliotekat ne Hade, Koliq dhe në Viti të Marecit. Numri i librave të shkatërruar është dikund rreth 23.000. Sot nuk ka kontakte në mes të bibliotekës kryesore komunale dhe degëve në fshatrat serbe, p.sh., në Jugoviq.

Biblioteka kryesore komunale në Prishtinë "Hivzi Sulejmani", përfshin dhomat e leximit për fëmijë dhe të rritur. Me përjashtim të dhomave të leximit, pjesët tjera janë në gjendje të keqe, me lagështi dhe myk. Disa dritare janë dëmtuar nga goditja gjatë bombardimeve por janë riparuar, dhe serbët i kanë marrë të gjitha pajisjet teknike. Ekziston vetëm një kompjuter për krejt rrjetin. Tash për tash, biblioteka kryesore, së bashku me degët e saj, ka libra në katër gjuhë dhe me këtë sasi: 70.000 në shqip, 37.000 në serbisht, 3.000 në turqisht dhe 1.1000 në anglisht.

Para luftës, sistemi i bibliotekave në Prishtinë kishte një drejtor serb dhe 44 punonjës - 34 serbë dhe 10 shqiptarë, prej të cilëve 19 punonin në bibliotekën kryesore. Tash ajo i ka 32 punonjës - të gjithë shqiptarë - dhe edhe 19 punojnë në bibliotekën kryesore. Këto shifra nuk i përfshijnë punonjësit të cilët punojnë në degët që gjenden në vendet ku dominojnë serbët.

Prej vitit 1992, ish-drejtori serb i bibliotekës, z.Dragolub Petroviç, nuk kishte blerë më libra në gjuhën shqipe. Në rafte ishin librat më të reja të shtypur në gjuhën serbe, derisa ato në shqipe dhe në gjuhë të huaj ishin më të vjetra. Librat në gjuhën serbe po mirëmbahen në biblioteka.

Sipas z.Pireva, nevojat më të mëdha janë ripërtirja e koleksioneve, rindërtimi i degëve të dëmtuara të bibliotekave, dhomat e reja për bibliotekën kryesore dhe dhoma më të mëdha. Mungesa e librave në gjuhën shqipe ka bërë që të bie numri i lexuesve, posaçërisht në mesin e fëmijëve. Para vitit 1992, regjioni kishte 15.000 lexues të rinj të regjistruar e tash vetëm 4.000 sish.

Sipas raportit të znj.Tania Vivitsky nga Fondacioni Sabre, biblioteka kryesore e fëmijëve, e cila gjendet në një ndërtesë që i është dhuruar bibliotekës nga një shkrimtar i njohur kosovar, është mirë e pajisur me mobile të fëmijëve, mirëpo është mjaft e shkretë edhe me libra e edhe me dekorime muri (posterë etj.). Për shkak të vështirësive në të holla, tash kjo bibliotekë nuk mundet as të ngjese shenjë në derë. Sipas Drejtorit, përparësi për furnizime të reja i jepet librave në shqip, por edhe atyre në anglisht e jo vetëm librave në anglishte. Furnizimet mund të jenë materiale të ndryshme edukative në anglishte si posterë, kashelashe, lodra etj. Të përshtatshme për fëmijë parashkolorë dhe të shkollave fillore dhe të mesme. Për studentë dhe të rritur, përparësi në libra të dhuruara në gjuhën angleze kanë librat shkencorë, të biznesit dhe ekonomisë si dhe romanet.

Biblioteka ia ka dorëzuar IOM-it një dokument i cili i përshkruan nevojat më të mëdha të rrjetit bibliotekar, i cili ka rezultuar në një bashkëpunim edhe me IOM-in edhe me KFOS-in, të cilët furnizojnë me libra fëmijësh.

#### Biblioteka Komunale e Glogovcit

Sistemi i bibliotekës komunale në Glogovc ishte shumë i dëmtuar gjatë luftës. Biblioteka kryesore që gjendet në një barakë druri buzë një shkolle është gjuajtur me mortajë dhe është djegur, sigurisht dikund rreth 20 prillit 1999. Biblioteka kryesore kishte 32.000 libra prej të cilave kanë mbetur vetëm 380. Komuna i ka pasur 7 biblioteka publike me gjithsejt 73.000 libra, duke i përfshirë 6 degë në Tërstenik, Komoran, Arllat, Sankoc, Baicë dhe Gradicë. Tri biblioteka, duke e përfshirë kryesoren, janë djegur dhe tri të tjera janë dëmtuar rëndë. Janë shkatërruar gjithsejt rreth 66.5000 libra. Raportohet se forcat serbe e kanë vrrarë bibliotekistin Izet Elshani (48), baba i katër fëmijëve, kanë djegur bibliotekën me 9.5000 libra, ia kanë përzenë familjen me dhunë dhe e kanë djegur shtëpinë e Izetit.

Sot, në fakt, komuna e Glogocit ka vetëm një bibliotekë me rreth 6.5000 libra. Sipas drejtorit të Sektorit të Kulturës dhe Sportit, z.Xhemë Binaku, ka plane për t'i hapur tri biblioteka prej të cilave njëra është kryesorja. Sidoqoftë, ende nuk ka libra dhe është e pasigurtë nëse ka vend dhe ndërtesë të përshtatshme. Për më shumë, ekziston edhe problemi i rrogave: sistemi bibliotekar punëson gjashtë punonjës bibliotekarë dhe vetëm njëri prej tyre ka marrë rrogë deri më tash. Deri në vitin 1991, biblioteka kishte 8 bibliotekistë, por atëherë u përjashtuan bibliotekistët shqiptarë.

Ka nevojë të madhe për fonde që të ndërtohet libraria kryesore ose të renovohen ndërtesat e tashme, për të gjetur libra të rinj, në mënyrë që të zëvendësohen humbjet dhe që të blehen pajisjet dhe mobiliet.



#### 4.3.2 Rrethi i Pejës

Peja, Istogu, Klina, Deçani, Gjakova

*Rrethi i Pejës përbën pjesën më të madhe të pjesës Perëndimore të Kosovës dhe kufizohet me Republikat Federale Jugosllave të Serbisë dhe Malit të Zi në veri dhe me Shqipërinë në jug.*

##### Biblioteka komunale e Pejës

Para masave të dhunshme të Serbisë, komuna e Pejës kishte 6 biblioteka publike me 87.212 libra. Luftën e kanë mbijetuar vetëm biblioteka e Pejës dhe dega e bibliotekës në Gorazhdec, e cila shumicën e librave i ka në gjuhën serbe. Katër degë të bibliotekës në fshatrat Vitomiricë, Baran, Tërstenik dhe Zahaq janë djegur nga serbët dhe janë shkatërruar 20.171 libra.

Biblioteka kryesore komunale në Pejë, e cila ka pasur rreth 65.000 libra, e mbijetoi luftën, edhe pse pjesë të mëdha të qytetit u shkatërruan. Biblioteka gjendej në Shtëpinë e Kulturës, por pas luftës kjo ndërtesë u kërkua nga UNMIK-u dhe tash në te gjendet stacioni qendror i policisë së UNMIK-ut. Librat e bibliotekës ruhen të mbyllura në një dhomë në katin e katërt të ndërtesës. Nuk kemi pasur kohë të shkojmë në te, por i kemi parë disa mbeturina të instrumenteve dhe librave nga Shkolla e Muzikës në Pejë. Edhe pse mbahen në dhoma të sigurta, janë trajtuar dhe mbajtur pa kujdes dhe me siguri nuk do të jenë shumë të dobishme në të ardhmen.

Z.Marco Mayer, përgjegjës i UNMIK-ut në Pejë për kulturë, na siguroi se rihapja e bibliotekës është njëri prej prioriteteve të administratës së UNMIK-ut dhe se ai ishte duke punuar në gjetjen e vendit të përshtatshëm për bibliotekë. Është në dispozicion një vend me dy dhoma, por ky vend është duke u shqyrtuar edhe si vend i ri i Qendrës së të Rinjve. IRC-ja (Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit) ka treguar intersim për financimin e disa aktiviteteve kulturore në Pejë, por si duket preferon Qendrën e të Rinjve. Përkundër kësaj, gjatë qëndrimit tonë në qytet u mor vendimi për rihapjen e bibliotekës në vend të ri.

Ka nevojë të madhe për fonde për ndërtimin e një biblioteke të re ose për rikonstruktimin e një ndërtese të përshtatshme. Vendimi për ta rihapë bibliotekën me dy dhoma duhet të shihet si i përkohshëm. Rikonstruktimi i vërtetë duhet t'i përfshijë dhomat e leximit, bibliotekën e fëmijëve, librat e ri, qasjen e lexuesve në kompjuterë dhe pajisje e mobilie të reja të të gjitha llojeve.

Z.Marco Mayer na i konfirmoi informatat të cilat i kishim nga studimi i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare për bibliotekat në Kosovën Perëndimore (Deçan, Klinë, Istog dhe Gjakovë).

##### Biblioteka komunale e Gjakovës

Para masave të dhunshme serbe me 1989, komuna e Gjakovës kishte 7 biblioteka publike, me gjithsejt 105.443 libra. Biblioteka kryesore kishte 42.913 libra, derisa degët në Skivjan, Rogovë, Biztazhin, Ponoshec, Brekoc dhe Cërmjanë kishin 63.250 libra.

Biblioteka kryesore nuk është dëmtuar, mirëpo dy prej gjashtë degëve janë djegur, si duket nga "Dora e zezë" serbe në prill ose maj të 1999-ës. Një prej këtyre, në Cërmjan, gjendej në një shkollë fillore. Sot, Gjakova ka vetëm pesë biblioteka, me gjithsejt 83.061 libra. Numri i përgjithshëm i librave të shkatërruar është 22.382. Sot, funksionojnë vetëm tri degë të bibliotekave.

Biblioteka kryesore komunale e Gjakovës gjendet në katin e parë të Shtëpisë së Kulturës së këtij qyteti dhe ka dy dhoma të hapura për publikun, një dhomë leximi me 20-30 ulëse dhe një dhomë ku mbahen librat. Biblioteka rinisi punën me 1 shkurt 2000. Në përgjithësi, kanë shpëtuar të gjitha librat dhe i vetmi dëm i bërë ka qenë çrregullimi i dhomës së leximit, por tash e dhjetë vjetë nuk është blerë asnjë libër në gjuhën shqipe. Biblioteka mbante rreth 25.000 libra në shqip dhe 15.000 në serbo-kroatisht, por sot kanë mbetur vetëm 5.000 libra në serbisht. Sipas drejtorit, z.Masar Peja, librat e tjerë i kanë marrë serbët.

Z.Peja është caktuar drejtor në vitin 1989, por në vitin 1990 është transferuar në pozitën e rojës e mandej u përjashtua nga puna. Biblioteka kryesore tash punëson pesë persona - të gjithë shqiptarë, por para luftës punonin me ndërrime dy serbë dhe dy shqiptarë. Serbët janë larguar me të hyrë KFOR-i në Kosovë, më 13 qershor 1999.

Kur e pyetëm për bibliotekat e tjera në rajonin e Gjakovës, z.Peja na tha se të gjitha bibliotekat e shkollave fillore e kishin mbijetuar luftën. Ai, po ashtu, na informoi se një fabrikë vendore tekstili, po ashtu, kishte bibliotekën e vet, mirëpo nuk dinte se në çfarë gjendje ishte ajo. Ai nuk kishte informata as mbi bibliotekën në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Mësimdhënësve në Gjakovë.

Z.Peja na foli për nevojën e madhe për raftet e librave, libra të rinj e, po ashtu, libra në gjuhë të huaja (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), kompjuterë dhe pajisje të tjera (biblioteka nuk ka telefon). Ka kërkesë për libra për studentë të shkencave të ndryshme si kimia, ekonomia, teknika dhe mjekësia. Studentët janë shumë të interesuar për libra në gjuhë të huaja. Sot shumica e lexuesve i sjellin librat e tyre kur vijnë në dhomat e leximit. Ai tha se i kanë vizituar shumë OJQ, por deri më tash nuk kanë marrë kurrfarë ndihmash.

Ai, po ashtu, na informoi se biblioteka kishte plane për hapjen e një librarie të vogël përkaj hyrjes në katin përdhësë, me qëllim të shitjes së librave me çmim më të lirë dhe për të siguruar fitime për bibliotekën.

#### 4.3.3 Rrethi i Mitrovicës

Mitrovicë, Laposaviq, Zveçan, Zubin-Potok, Skënderaj, Vushtrri

*Rrethi i Mitrovicës është më veriori i Kosovës dhe kufizohet me Republikën e Serbisë në veri-perendmi, veri dhe verilindje. Rrethi tash është qartazi i ndarë në pjesën veriore të dominuar nga serbët, që përbëhet prej komunave të Laposaviqit, Zveçanit dhe Zubin-Potokut, dhe prej pjesës së Mitrovicës në veri të lumit Ibër dhe në pjesën jugore, ku banojnë shqiptarët - përfshin Vuhtrrin, Skënderajn dhe Mitrovicën Jugore.*

Biblioteka komunale e Mitrovicës

Biblioteka komunale e Mitrovicës gjendet në jug të lumit Ibër, në pjesën e qytetit që tash kryesisht është e banuar nga shqiptarët. Prej vitit 1945 biblioteka ka funksionuar si bibliotekë komunale dhe rajonale. Sistemi i bibliotekës komunale përbëhet prej bibliotekës kryesore dhe gjashtë bibliotekave të rretheve ose degëve, dy prej të cilave, ajo e Tunelit të Parë dhe e "Trepçës", janë shkatërruar nga serbët gjatë luftës. Në dhjetor, UNMIK-ut i është dorëzuar plani i rindërtimit të bibliotekës në Tunelin e Parë. Para luftës vepronin vetëm tri degë të bibliotekës.

Sot, biblioteka kryesore ka 117.206 libra; 62.995 në shqip, 51.819 në serbisht dhe 2.392 në turqisht. Biblioteka e mbijetoi luftën pa ndonjë dëmtim serioz në vetë ndërtesën me 1.089 metra katrorë, edhe pse disa rafta më të vjetruara ranë për shkak të shpërthimit dhe dridhjeve të një eksplodimi afër ndërtesës. Gjatë luftës, serbët morën të gjitha pajisjet teknike (telefonat, faksat etj.).

Drejtori i tashëm, z.Hajrulla Mustafa, është drejtori i parë joserb i bibliotekës. Ai e karakterizoi bibliotekën si qendër kulturore të qytetit, meqenëse është institucioni i vetëm kulturor që funksionon në Mitrovicë – KB-ja tash është duke e përdorë ndërtesën e Shtëpisë së Kulturës. Biblioteka ofron shërbime për fëmijë dhe të rinj, si dhe për profesionistë. Qysh prej luftës e këtij biblioteka ka qenë nikoqire e 17 mbledhjeve dhe ngjarjeve të ndryshme kulturore. Interesimi për lexim është duke u rritur dhe biblioteka tash ka më shumë shfrytëzues se para luftës. Nuk ka mjaft libra për fëmijë. Biblioteka ofron shtypin ditor dhe shumë të papunë vijnë në të për t'i lexuar gazetatat.

Bibliotekës i duhen libra të rinj në shqip, serbisht, anglisht dhe në gjuhë të tjera evropiane. Njerëzit dëshirojnë të mësojnë gjuhë të reja. Ka nevojë të veçantë për literaturë profesionale në gjuhë të huaja.

Pas luftës është themeluar një projekt bibliotekar (33.000 DM), me ndihmën e Organizatës Humanitare "Shërbimi i Komitetit i Miqve Amerikanë", i cili e mundësoi pajisjen me 18.300 libra të rinj.

Në një takim të shkurtër në Shtabin rajonal të UNMIK-ut në Mitrovicë, z.Ahmad Shamsu Deen-Cole, zyrtar i Çështjeve Qytetare për Kulturë i UNMIK-ut, në përgjithësi konfirmoi informatat që i kishim nga studimi i BKU-së mbi bibliotekat në rajon. Rehabilitimi i duhet bibliotekave në Vushtrri e posaçërisht në Skënderaj. Ajo në Mitrovicë është pak a shumë në rregull dhe biblioteka në Zubin-Potok duhet rehabilituar, sepse është viktimë e lënies pas dore.

Biblioteka komunale në Laposaviq

Bibliotekat komunale në Laposaviq, në enklavën veriore serbe, janë relativisht të padëmtuara. Sot, sistemi përbëhet prej bibliotekës në vet qytetin, dy degë në Leshak dhe Soçanicë dhe një bibliotekë shkollore në Vraçevë, që i shërbejnë një pjese të banuar me 15.000 njerëz.5.000 sosh jetojnë në Laposaviq. Sot, 98 % e popullsisë janë serbë. Kanë ekzistuar tre fshatra shqiptare në këtë pjesë. Po ashtu, ka pasur një degë bibliotekë në Banjë, por ajo nuk vepron më. Numri i librave përfshin 13.500 libra; dega në Leshak 5.392 dhe ajo në Soçanicë 6.702. Furnizimet e reja i marrin nga Ministria Jugosllave e Kulturës, por nuk kanë hapësirë. Biblioteka nuk ka pajisje teknike si fotokopjues, faks, kompjuter ose televizion.

Pas luftës në qytet janë bartë tri institucione të reja arsimore: Kolegji i Gjinnastikës dhe i Sporteve, Shkolla e Lartë e Ekonomisë dhe e Biznesit, si dhe Gjinnazi i Mësimdhënësve. Nuk ka bashkëpunim me sistemet tjera bibliotekare. Para luftës, huazimet ndërbibliotekare kanë qenë të zakonshme, por më nuk bëhen. Sistemi punëson 10 vetë; drejtorin, gjashtë bibliotekistë, dy nëpunës administratues dhe një asistent. Dy bibliotekistë punojnë në Soçanicë e një në Leshak. Bibliotekat kanë rreth 1.00 shfrytëzues të regjistruar me përqindje të madhe të fëmijëve e të rinjve (më shumë se 50%). Ka rënie në huazime të librave - prej 20.000 në 15.000.

Biblioteka komunale në Vushtrri

Deri në vitin 1990 biblioteka komunale në Vushtrri kishte 9 biblioteka publike, me 77.284 libra. Biblioteka kryesore kishte 34.000 libra derisa 8 degët në Maxhunaj, Dumnicë, Samadrexhë, Pantinë, Strofc, Duboc, Smrekonicë dhe Prelluzhë kishin diçka më shumë se 43.000 libra.

Sot, funksionojnë biblioteka kryesore dhe 5 degë, edhe pse biblioteka kryesore i ka humbur më shumë se 16.000 libra dhe janë djegur prej serbëve lokalë degët në Strofc e Duboc. Është shkatërruar edhe ndërtesa e bibliotekës në Dumnicë,

por disa libra kanë mbijetuar dhe mbahen në një klasë në shkollën e fshatit. Janë dëmtuar bibliotekat në Smrekonicë dhe Prelluzhë. Gjithsejt, janë shkatërruar rreth 38.000 libra dhe shumë inventar. Biblioteka në Pantinë është rihapur vetëm në shkurt të vitit 2000.

Prelluzha është katund i dominuar nga serbët etnikë, kështu që drejtori z. Izet Aliu, nuk mund të na jepte informata për shkak se nuk kishte kontakte me ta: "Nuk guxojmë të shkojmë atje". Bibliotekistët e bibliotekës kryesore thanë se kanë provuar të flasin me kolegët e tyre në Prelluzhë, por ata nuk duan të bashkëpunojnë.

Në vitin 1992 shqiptarët u përjashtuan nga biblioteka kryesore, por vazhduan të punojnë në sistem paralel, të bazuar në degët e bibliotekave nëpër fshatra. Sipas drejtorit, sistemi bibliotekar punëson 11 persona, 4 në bibliotekën kryesore dhe 7 nëpër degë. Biblioteka kryesore gjendet në Shtëpinë e Kulturës, por është shndërruar në njësi të pavarur administrative me 1 mars 2000. Udheheqësia e re e Shtëpisë së kulturës e ka aprovuar këtë gjendje të re.

Bibliotekave në këtë rajon u duhet rehabilitimi; objekte më të mira, më shumë hapësirë dhe dhoma leximi, libra të rinj (janë shkatërruar gati gjysma e librave) dhe kompjuterë.

#### Biblioteka publike e Skënderajt

Para vitit 1990 komuna e Skënderajt kishte 7 biblioteka publike me rreth 68.000 libra. Biblioteka kryesore kishte 20.000 libra, kurse degët në Likoc, Turizek, Runik, Klinë e Epërme dhe Prekaz i Epërm kishin 48.000 libra. Krejt degët e kësaj ane janë shkatërruar në një masë nga "Dora e Zezë" serbe; vetëm dy ndërtesa të bibliotekave shpëtuan - të tjerat janë djegur - dhe krejt librat janë zhdukur.

Biblioteka kryesore komunale e Skënderajt ka shpëtuar me disa dëmtime të vogla. Por, nuk funksionon. Biblioteka gjendet në Shtëpinë e Kulturës dhe administrohet nga ajo. Ndërtesa është e re dhe moderne, por vuan për shkak të viteve të tëra të lënies pas dore. Kulmi rrjedhë dhe të gjitha pajisjet dhe orendi janë marrë. Edhe pse i paprekur, koleksioni i librave është në gjendje shumë të keqe; disa libra janë dëmtuar nga uji, disa janë marrë e të tjerat janë keqtrajtuar. Disa libra janë përdorë si gur hecjeje për të kapërcyer nëpër ujë. IRC-ja (Internationoal Rescue Committee) planifikon ta fillojë rehabilitimin e ndërtesës këtë verë dhe ka premtuar të ndihmojë edhe me orendi të reja. Sistemi bibliotekar sot punëson katër persona.

#### 4.3.4 Rrethi i Gjilanit

Gjilan, Shtërpcë, Kaçanik, Viti, Ferizaj, Novobërdë, Kamenicë

*Rrethi i Gjilanit gjendet në skajin juglindor të Kosovës. Rrethi kufizohet me Maqedoninë në jug dhe me Republikën e Serbisë në lindje.*

#### Biblioteka komunale e Gjilanit

Para vitit 1990 komuna e Gjilanit kishte 14 biblioteka publike, me 167.562 libra. Biblioteka kryesore kishte përafërsisht 74.000 libra (65 % në shqip), derisa degët në Zhegër, Pogradje, Bresalc, Përlepnice, Pasjan, Koretisht, Partesh, Budrikë e Ulët, Dobërçan, Cërnice, Malishevë, Llashticë dhe Shurdhan kishin 95.546 libra.

Sot, komuna e Gjilanit ka 10 biblioteka që funksionojnë me gjithsejt 116.832 libra. Biblioteka kryesore është hapur pas luftës, më 21 qershor 1999. Katër biblioteka në këtë komunë, ato të Dobërçanit, Cërnices, Malishevës dhe Shurdhanit janë shkatërruar dhe mbyllur qysh nga viti 1990. Tri prej këtyre degëve janë djegur, ndërsa e katërta në Malishevë është mbyllur para 8 vjetëve dhe nuk ka qenë e mundur të hapet. Kjo bibliotekë ka qenë e përzier - shqiptare dhe serbe - dh librat në gjuhën serbe prej saj janë dërguar tjetërkund. Katër degë të tjera në Pasjan, Partesh, Budrikë e Ulët dhe Koretishtë gjenden në pjesët serbe. Sipas drejtorit të bibliotekës komunale, z. Shefki Osmani, ato janë në rregull dhe veprojnë, por nuk mbajnë kontakte me sistemin bibliotekar komunal.

Biblioteka kryesore pothuajse nuk ka pësuar asgjë - mungonin vetëm 2.000 tituj, por bibliotekat nëpër katunde kanë humbur më shumë se 64.000 libra në gjuhën shqipe. Qysh prej përfundimit të luftës, degët e bibliotekave kanë marrë 11.000 libra të ri, por "jo ato që i duan lexuesit", tha z. Osmani. Biblioteka kryesore ende mbanë libra në shqip (64%), serbisht, turqisht dhe anglisht. Pothuajse gjithë titujt në gjuhën shqipe janë botuar para 1990-ës.

Biblioteka e Gjilanit nuk kanë marrë kurrfarë ndihmash prej OJQ-ve ndërkombëtare, por kanë marrë ndihma nga ndërmarrjet vendore, p.sh., nga kompania vendore "Kompakt". Sistemi bibliotekar i komunës së Gjilanit është njëri prej më funksionalëve në Kosovë që, përkundër situatës së vështirë, gjeti mënyrën t'ia dhurojë 1000 tituj bibliotekës në Gllgovc.

Ka mungesë të punonjësve të kualifikuar dhe punonjësit e tashëm nuk janë paguar qysh prej se kanë nisur të punojnë pas luftës. Biblioteka nuk ka një dhomë të mirë leximi dhe inventarë. Nuk ka as kompjuter, faks ose fotokopjues.

#### Biblioteka komunale e Ferizajt

Para vitit 1990, komuna e Ferizajt kishte 7 biblioteka publike me 60.565 libra. Biblioteka kryesore kishte 30.913 libra,

derisa degët në Gaçkë, Kamogllavë, Talinoc të Muhaxherëve, Nerodime, Babush dhe Shtërpcë kishin 29.252 libra, por edhe këtu janë shkatërruar bibliotekat, duke përfshirë edhe ndërtesat dhe librat. Komuna tash ka 2.700 libra për fëmijë (përpara kishte 10.705-gati 75% në shqip) dhe 5.647 për të rritur ( përpara kishte 20,208). Degët e bibliotekave tash kanë vetëm 16.652 libra, gjithsejt. Degët në Shtërpcë dhe Babush janë shkatërruar e në Nerodime librat janë zhdukur e ndoshta janë shkatërruar.

Biblioteka kryesore ka vetëm një dhomë leximi dhe nuk ka hapësirë për fëmijë. Drejtoresha, znj.Servete Krasniqi-Hajrullahu, e cila është caktuar drejtoreshë pas luftës, na informoi se është duke u rindërtuar dega në Babush. Sistemi i bibliotekave punëson 10-11 persona - tre në bibliotekën kryesore. Asnjëri prej të punësuarve nuk ka marrë rrogë prej pas lufte, dhe prej vitit 1987 nuk janë sjellë libra në gjuhën shqipe.

#### 4.3.5 Rrethi i Prizrenit

Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash

*Rrethi i Prizrenit gjendet në pjesën më jugore të Kosovës dhe në jugperëndim është i lidhur me Shqipërinë me kufi malor e në juglindje kufizohet me Maqedoninë.*

Biblioteka komunale e Prizrenit

Para vitit 1990, komuna e Prizrenit kishte 8 biblioteka publike, me gjithsejt 82.293 libra. Biblioteka kryesore në Prizren kishte 54.462 libra ndërsa degët dhe bibliotekat e kombinuara në Zhur, Velezhë, Sredski, Lubizhdë, Piranë, Mamushë dhe Zym kishin 27.831 libra. Në përgjithësi, bibliotekat mbijetuan luftën pa dëme të mëdha, edhe pse biblioteka në Zhur, fshati më i komunës, u dëmtua prej bombardimit të NATO-s. Librat nga kjo bibliotekë kanë shpëtuar dhe tash mbahen në bibliotekën kryesore. Drejtori i Shtëpisë së Kulturës, z.Dashnor Xërxa, na informoi se po bëhen përpjekje për të gjetur lokacion të ri dhe për ta rinisur punën e kësaj dege të bibliotekës. Janë shkatërruar ose marrë, nga e gjithë komuna, gjithsejt 24.000 libra.

Biblioteka kryesore në Prizren është themeluar me 1944 dhe ka rinisur punën menjëherë pas luftës, më 15 qershor 1999. Tash kjo bibliotekë mbanë 39.945 libra; 12.682 libra në shqip, 22.216 në serbisht, 5.382 në turqisht dhe 79 në gjuhët e huaja. Nuk ka pasë furnizime të reja gjatë dhjetë vjetëve të fundit e edhe ata libra që janë, janë në gjendje të keqe. Biblioteka kryesore gjendet në Shtëpinë e Kulturës dhe ende administrohet nga ajo. Kuvendi komunal do të vendose se a do të bëhet biblioteka institucion i pavarur. Në vitin 1991, shqiptarët u përjashtuan nga bibliotekat, edhe pse disa ende punonin aty. Biblioteka nuk ka drejtor, pos një serbi që ka qenë drejtor në vitet 1998-1999. Biblioteka tash ka tre bibliotekistë profesionistë të punësuar dhe z.Xërxa së shpejti do t'i kërkojë edhe 2 ose 3. Sot, kjo bibliotekë mban rreth 18.000 libra. Degët në Velezhë, Lubizhdë dhe Piranë janë biblioteka të kombinuara me ato shkollare e gjenden në lokale të shkollave. Biblioteka e Zymit është mbyllur me 1988, por është rihapur në janar 2000, dhe tash udhëheqet nga një bibliotekist profesional. Të gjitha degët tjera drejtohen nga mësuesit e shkollave dhe ende nuk funksionojnë. Biblioteka në Mamushë, që ishte bibliotekë turke, tash është e mbyllur por librat mbahen në bibliotekën kryesore. Sredski është katund etnik serb dhe biblioteka gjendet në Shtëpinë e Kulturës. Kjo bibliotekë nuk ka kontakte me biblioteka e tjera në komunë dhe z.Xërxa nuk kishte informata mbi gjendjen e kësaj biblioteke.

Z.Xërxa vuri në dukje nevojën për lokacione të reja të degëve të bibliotekave, nevojën e gjithëmbarshme për libra të ri dhe së paku tre kompjutorë. Ai ia kishte dorëzuar kërkesën për një gjenerator administratës së UNMIK-ut dhe atij ia kishin premtuar shumën prej gjithsejt 3.000 DM, por ende i mungonin 2.000 DM.

Z.Xërxa, i cili është profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike, na informoi se Fakulteti ka një bibliotekë të mirë, duke përfshirë edhe dhomën e leximit, literaturës profesionale lidhur me fizikë, kimi, matematikë, pedagogji dhe letërsi shqipe.

Biblioteka komunale e Malishevës

Para vitit 1990, komuna e Malishevës ka pasur pesë biblioteka publike, me gati 41.000 libra. Biblioteka kryesore kishte 13.000 libra, ndërsa degët e bibliotekës në Kijevë, Bajë, Bellanicë dhe Lubizhdë, kishin 28.000 libra. Gjatë dhjetë viteve të fundit, e sidomos gjatë luftës së zhvilluar më 1999, bibliotekat në këtë komunë faktikisht janë shkatërruar pothuaj tërësisht. Sot, në degën e bibliotekës në Kijevë kanë mbetur vetëm 1.096 libra, ndërkohë që të gjitha bibliotekat tjera janë shkatërruar.

Biblioteka kryesore komunale ishte djegur në korrik të vitit 1998 dhe tri degët në korrik të vitit 1999. Njësitë speciale serbe bartin përgjegjësinë për djegien e shtëpive. Ata kanë shfrytëzuar njësi të ndryshme për qëllime të ndryshme. Shtëpitë që janë djegur nuk janë zgjedhur në mënyrë të parregullt, ato në të cilat është dyshuar të ketë zyre kanë pasur përparësi. Kjo komunë është ndër komunat më të dëmtuara sa i përket bibliotekave dhe librave të bibliotekave, meqenëse si ndërtesat, ashtu edhe librat dhe dokumentet, janë shkatërruar.

Malisheva ka 60.000 banorë dhe konsiderohet të jetë njëra prej pjesëve më të varfëra të Kosovës. Nuk ka fabrika, shtëpi të kulturës, madje komunës i mungojnë edhe kanalizimet. Kjo zonë ka qenë nën kontrollin e UÇK-së për tre muaj gjatë vitit 1998 dhe vetëm 3 prej 45 fshatrave ishin të padëmtuara pas luftës. 21 shkollat e kësaj ane, duke përfshirë edhe bibliotekat e shkollave, janë djegur - shkollat në qytezë janë rindërtuar, por mësimi ende zhvillohet në tenda nëpër fshatra.

Edhe shkolla e mesme, së bashku me bibliotekën, janë djegur. Ndërmarrjet lokale gjithashtu kanë pasur biblioteka të vogla profesionale, por çdo gjë është djegur. Prefekti i Malishevës, z.Gani Krasniqi, tha: "Serbët, jo vetëm që nuk kanë investuar, por kanë shkatërruar edhe ato pak gjëra që kanë ekzistuar".

Autoritetet komunale kanë gjetur një vend për një bibliotekë të re kryesore, por u nevojitet përkrahja e OJQ-ve dhe UNMIK-ut për t'i rivendosur shërbimet bibliotekare.

#### Biblioteka komunale e Rahovecit

Para vitit 1990, komuna e Rahovecit ka pasur pesë biblioteka publike, me afro 49.000 libra. Biblioteka kryesore kishte 15.320 libra, ndërsa degët e bibliotekës në Ratkoc, Krushë të Madhe, Xërxë dhe Hoçë të Madhe kishin 33.786 libra. Biblioteka kryesore në qendër të Rahovecit nuk është djegur, por ndërtesa është në gjendje tepër të keqe (kulmi lëshon ujën) dhe pothuaj të gjitha librat janë shkatërruar apo janë vjedhur. Biblioteka nuk është duke funksionuar dhe kolekcioni i vogël i 1.200 librave të mbetur në gjuhën serbokroate është deponuar në shtëpinë e kulturës. Tri degët e bibliotekës janë djegur krejtësisht, ndërkohë që dega e katërt e bibliotekës në Krushë të Madhe është biblioteka e vetme që ende punon në këtë komunë.

34 fshatra në këtë zonë janë djegur dhe sipas prefektit, Agim Thaçit, i vetmi fshat që ka shpëtuar është një fshat serb. 10.226 shtëpi janë djegur. Ai planifikon t'i rihapë 10 biblioteka, duke përfshirë edhe biblioteka të përziera shkollore dhe publike në Qifllak, Drenoc, Malësi të Vogël dhe Raposte. Koordinatori komunal për Kulturë, z.Fehmi Hoxha, na informoi se të gjitha bibliotekat shkollore janë shkatërruar, duke përfshirë edhe bibliotekën e shkollës së mesme me dy degët në Rahovec dhe Krushë të Madhe.

Z.Hoxha po ashtu na informoi se ia ka përcjellur një plan prej 118.000 DM për rehabilitimin e ndërtesës dhe shërbimeve të saja THW-së, një OJQ-je gjermane, selia ballkanase e së cilës gjindet në Rahovec. Në plan përfshihet muzeu, një galeri e artit dhe rindërtimi në shkallë të vogël i bibliotekës (37.534 DM) ku parashihen riparimet në objekt, dhomë të leximit dhe orendi si dhe furnizimi me 3.500 libra të fëmijëve, 3.000 librave për të rritur dhe 100 librave tjerë shkencorë. Shtëpia e kulturës gjendet në një ndërtesë të ndërtuar më 1962, por mirëmbajtja e objektit ka qenë nën çdo nivel. Nuk ka rrymë, e as gjenerator. Ai ka kërkuar nga autoritetet komunale që ta ofrojnë një ndërtesë të re për bibliotekë. "Kultura është përvojë, ne duhet të investojmë në kulturë, por nuk e kuptojnë të gjithë rëndësinë e kësaj", përfundoi z.Hoxha.

Nuk ka staf profesional të punësuar në bibliotekë, përveq bibliotekistit në Krushë të Madhe, z.Bajram Nalli, që është edhe koordinator i shtëpisë së kulturës. Biblioteka në Krushë të Madhe dikur kishte 12.000 libra (disa prej të cilëve ishin në gjuhën serbe), por 6.000 libra apo 2.500 tituj kanë humbur. Shumica e librave janë shkatërruar gjatë huazimit, së bashku me shtëpitë e shfrytëzuesve të bibliotekës. Z.Nalli kishte humbur 2 djemtë e tij, dy vëllezër dhe pesë nipa në masakrin që serbët kryen në këtë fshat, por prapë planifikonte t'i ruante librat në gjuhën serbe. Sot, biblioteka i shërben 400-600 lexuesve. Biblioteka e z.Nallit dhe shtëpia e kulturës kanë pasur përkrahjen e ISC-së (Qendrës Sociale Italiane). Kjo bibliotekë, e vetmja funksionale, së shpejti do të hiqet apo mbyllet për shkak se UNMIK-ut i nevojiten objektet për procesin e regjistrimit si përgatitje për zgjedhjet lokale në vjeshtë.

#### 4.4 Bibliotekat shkollore

Pjesa dërmuese e bibliotekistëve me të cilët jemi takuar gjatë qëndrimit tonë në Kosovë kanë lëshuar rrënjë qoftë në biblioteka publike apo akademike. Të pyetur rreth bibliotekave shkollore ata zakonisht janë përgjegjur se çdo shkollë fillore ka bibliotekën e saj dhe se ato ishin të padëmtuara dhe kishin mbijetuar luftën. Këto përgjigje kundërshtohen me faktin se shumica e degëve të bibliotekave publike të shkatërruara gjendeshin në fshatra dhe shpesh kanë shërbyer si biblioteka publike dhe shkollore njëkohësisht. Përpos kësaj, është e ditur se edhe në statistikat zyrtare të RFJ-së nuk parashihet se çdo shkollë ka pasur nga një bibliotekë. Dhe, duke pasur parasysh sistemin arsimor të Kosovës që nga vitit 1998 - një sistem i dominuar nga pala serbe dhe sistemi paralel jozyrtar shqiptar, për një gjë të tillë ka aq më pak gjasa. Ata, si duket, më shumë i referohen qëllimeve të akteve ligjore, se sa fakteve të vërteta.

Këto deklaratat mund të ndodhë të jenë pasqyrim i brengosjes se përpjekjet potenciale për ndihmë dhe kontributet e donatorëve është dashur t'i drejtohen sektorit të arsimit, në vend të institucioneve të veta, apo thjesht mungesë e dijenisë së vërtetë sa i përket kësaj çështjeje. Sido që të jetë, kjo vë në pah nevojën për komunikim dhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet sektorit të kulturës dhe atij të arsimit.

UNICEF-i ka vlerësuar gjendjen e 1.058 prej gjithsejt 1.200 shkollave fillore dhe të mesme në Kosovë. 873 janë shënuar për riparim - ndërkohë që 132 shkolla janë shkatërruar tërësisht dhe duhet rindërtuar plotësisht. Së bashku me këto shkolla, janë shkatërruar bibliotekat e shkollave.

Procesi i riparimeve tashmë ka filluar në 271 shkolla, ndërsa ka përfunduar në 379 shkolla. UNICEF-i ka financuar punën në 35 shkolla, riparimi i të cilave ka përfunduar, UNHCR-ja 96 dhe ECHO 111. Kryqi i Kuq dhe donacionet bilaterale përmes OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare kanë financuar mbetjen e shkollave.

Furnizimi me ujë dhe rrymë elektrike mungon në shumë shkolla; WC-të mungojnë ose janë në gjendje të keqe. Edhe mjetet e komunikacionit për rreth këtyre shkollave duhet të rindërtohen, qarqe ku shumica e shtëpive janë në gjendje të pabanueshme. Pas vjedhjes dhe shaktërrimit të orendive dhe pajisjeve të shkollave, shkollat kanë kërkuar banka, karriga

dhe tabela të zeza dhe UNICEF-i është angazhuar në disa projekte për dhënie e ndihmave, duke përfshirë edhe përkrahjen e autoriteteve lokale në përpjekjet e tyre për furnizim me libra shkollor.

Një nismë e koordinuar, DESK-u (Disenjimi i një Sistemi Arsimor për Kosovën) është në vazhdim e sipër, me qëllim të rindërtimit dhe zhvillimit të një sistemi të modernizuar arsimor. Për shkak të shkatërrimit të tërësishëm si pasojë e luftës, në fillim të vitit shkollor 1999-2000 nuk ka pasur libra për më se gjysmën e një milion nxënësve, sa vijojnë shkollat fillore dhe të mesme.

Nën udhëheqjen dhe kujdesin e UNMIK-ut, është themeluar një Konzorcium për Libra Shkollorë për Kosovën. Në Konzorcium janë përfshirë disa prej donatorëve më kryesorë: Qeveria Austriake / Zyra Federative, Qeveria Kanadeze / CIDA, Qeveria Daneze / DANIDA, Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar, DFID / Mbretëria e Bashkuar, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile / KFOS, Plataforma për Kosova / Spanjë, Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim / SDC, UNICEF-i dhe Departamenti - Zyra e Shteteve të Bashkuara për Popullsi, Refugjatë dhe Migrim / BPRM. Projektin e kanë koordinuar KFOS-i dhe OSI i Budapestit, ndërkohë që librat janë shpërndarë nëpërmjet rrjetit të Librit Shkollor, që mbulon çdo shkollë në Kosovë.

Konzorciumi ka pasur sukses në mbledhjen e mjeteve (afro 5 milionë marka gjermane) për shtypjen e 192 librave shkollorë në gjuhën shqipe, me qarkullim të përgjithshëm prej 3.2 milionë kopjeve, si dhe librave shkollorë në gjuhën serbe, boshnjake dhe turke. Deri më tash janë shtypur dhe shpërndarë 131 tituj, në përafërsisht 2 milionë kopje të veçanta. UNICEF-i në Prishtinë po e mbështet edhe botimin dhe dërgesën e librave shkollor nga Sarajeva në Kosovë për distribuim të menjëhershëm në mesin e nxënësve boshnjakë në Kosovë.

EU-ja (Arsimi Ndërkombëtar) ndihmon rindërtimin e objekteve shkollorë në Kosovë. Arsimi Ndërkombëtar ka filiale në Republikën Federative të Jugosllavisë. SBASHK-u (Sindikata e Bashkuar e Arsimi, Shkencës dhe Kulturës në Kosovë), njëra prej filialave, ka filluar të sigurojë shërbime arsimore për fëmijët dhe rininë kosovare.

Sikurse bibliotekarët, edhe mësimdhënësit shqiptarë të Kosovës, nuk kanë marrë paga që nga vjeshta e vitit 1998, që përfshinë periudhën para, gjatë dhe pas intervenimit të NATO-s. Një program i implementuar me ndihmën e UNICEF-it u ofron mjete mësimdhënësve.

Pas caktimit të standardeve ndërtimore për rehabilitimin dhe ndërtimin e shkollave, në konsultim me UNESCO-n, UNICEF-i së shpejti do të fillojë të kërkojë partnerë në mesin e OJQ-ve, për rindërtimin e shkollave të shkatërruara tërësisht, me donacion prej 24.3 milionë dollarëve të Qeverisë japoneze të siguruar nëpërmjet Fondit të Kombeve të Bashkuara për Siguri të Njeriut për një program dyvjeçar. Do të ndërtohen gjithsejt 73 shkolla, duke përfshirë edhe disa shkolla të reja. Rreth 300 shkolla do t'i kenë të përmbushura mjetet dhe nevojat më themelore, duke përfshirë ujën dhe nyjet sanitare, pasi që me hulumtimin që kreu UNICEF-i në korrik të vitit 1999 u dëshmuar se 22 % të shkollave nuk kanë ujë, se shumica e shkollave kanë nevojtoje të jashtme dhe vetëm disa prej tyre kanë nevojtoje të ndara për vajza dhe për djem. Me po të njëjtin donacion do të financohet edhe rrjeti prej 35 shkollave si mostër, ku do të zbatohen metoda të avansuara të mësimi dhe planprograme moderne, duke përfshirë shkolla me nxënës turk, serbë dhe boshnjakë. Përkrahja e autoriteteve arsimore në Kosovë do të financohet gjithashtu dhe, në ndërkohë, do të mundësohet edhe trajnimi i posaçëm për mësimdhënësit të fëmijëve me nevoja speciale.

Ka përpjekje në kuadër të sektorit arsimor për ta zgjidhur edhe çështjen e pajtimit dhe pluralizmit kulturor. Pas negociatave të gjata, shkolla në Janjevë më në fund ka përfshirë edhe nxënës kroatë dhe romë, përveç atyre shqiptarë. Mësuesit kroatë mbajnë orë në të njëjtën kohë si mësuesit shqiptar, vetëm se në klasa tjera. Shkolla ka një bibliotekë të vogël që përfshinë libra në gjuhën shqipe, serbe dhe kroate.

OSBE-ja ka filluar një projekt distribuimi më 20 mars. Me atë rast, shkollave anëmbanë Kosovës u janë ndarë 10.000 libra për fëmijë. Kjo ide lindi para një viti, kur mijëra njerëz ishin të vendosur nëpër kampe të refugjatëve në Maqedoni dhe Shqipëri, duke lënë çdo gjë pas në Kosovë dhe me ç'rast fëmijët e tyre patën humbur mbarë literaturën e tyre. Librat janë zgjedhur dhe financimin e bëri një OJQ, Capanamor. Deri sa janë shtypur librat, kampet janë zbratur. Ato libra tash janë të paketuara në pako gjashtëpjesëshe me drama, poezi, tregime të shkurtëra dhe dy romane, dhe u jepen fëmijëve, për të cilët edhe janë paraparë dhe përgatitur. Tani, në vend se t'u jipen fëmijëve në kampe, dhuratat shpërndahen nëpër klasat e shkollave të Kosovës.

#### 4.5 Bibliotekat fetare dhe koleksionet e librave

Misioni ynë nuk ka bërë ndonjë analizë të hollësishme të gjendjes së bibliotekave dhe koleksioneve të librave fetarë. Shkurtazi vizitua Patriarkën serbe Ortodokse afër Pejës dhe Manastirin e Ulpianës/Graçanicë, por nuk mundëm t'i takojmë njerëzit të cilët do të mund të na jepnin informata të hollësishme mbi situatën e bibliotekave ortodokse dhe mbi koleksionet e librave. Pa sukses u munduam të caktojmë takim me Atin Sava Janjiç, përfaqësuesi më i dalluar ndërkombëtarisht i komunitetit ortodoks serb, sepse ai ishte në SHBA gjatë kohës së vizitës sonë. Na është dhënë përshkrimi i përgjithshëm i shkatërrimit të kishave ortodokse. Janë shkatërruar 82 kisha serbe, pjesërisht apo plotësisht, gjatë dhe pas luftës. Disa prej tyre kishin dor[shkrime dhe libra të vjetra. Nuk dihet sa libra e dor[shkrime janë shkatërruar, por është e sigurtë se shumë kisha dhe manastire ortodokse serbe janë plaçkitur, djegur ose hedhur në ajër me eksploziv. Kjo informatë përkon me ato të dhëna nga mediat ndërkombëtare, e ne vetë e kemi parë kishën qendrore ortodokse të Gjakovës të shkatërruar. Me sa dimë ne, të gjitha kishat dhe monumentet fetare serbe tash mbrohen nga KFOR-i.

Në tetor 1999, Andras Riedlmayer, nga Biblioteka e Arteve të Bukura, Universiteti i Harvardit, SHBA, kaloi tri javë në Kosovë për ta kryer një analizë të gjendjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare, përfshirë edhe bibliotekat, pas luftës. Studimi, i përkrahur nga bursa prej Packard Humanities Institute, është kryer për t'i vlerësuar dëmet dhe për t'i gjetur institucionet dhe projektet që kërkojnë ndihmë. Raporti i tij jep informata të hollësishme mbi gjendjen e bibliotekave dhe koleksioneve të librave në bibliotekat fetare myslimane dhe ortodokse:

"Tri institucionet më të rëndësishme ortodokse serbe; Patriarkati në Pejë dhe manastiret në Deçan dhe Graçanicë, kanë koleksione bukur të mira prej kohës mesjetare dhe osmane. Këto përjetuan luftën pa dëme dhe tash ruhen nga forcat e KFOR-it; thuhet se disa nga materialet më të vlefshme janë bartur në Serbi, para se të fillojë lufta. Kish ortodokse po ashtu ka një seminar dhe bibliotekë teologjike në Prizren (Bogoslovija Sv. Kirila i Metodija, themeluar me 1871). Prej përfundimit të luftës në te strehohen refugjatët serbë; këtë ndërtesë e gjetëm të paprekur dhe të ruajtur nga KFOR-i gjerman.

Bibliotekat e dorëshkrimeve dhe arkivat historike të Komunitetit islam të Kosovës, që mbanin materiale të shkruara për 600 vjetët e kulturës islame në rajon, përjetuan shkatërrim të tmerrshëm. Humbja më serioze sa i përket arkivave joqeveritare ishte djegia e Arkivit Qendror të Komunitetit të Bashkësive Islame (KBI) në qendër të Prishtinës, që gjendej në një ndërtesë afër Xhamisë së Sulltan Muratit të ndërtuar në shekullin XV. Arkivi i Komunitetit Islam është djegur prej policëve serbë, më 13 qershor 1999".

Forcat serbe, po ashtu, shkatërruan koleksione të tjera madhore të dorëshkrimeve islame në Kosovë, gjatë marsit e qershorit 1999. Sipas Riedlmayer-it ndër humbjet më serioze janë:

- Djegia e bibliotekës së Hadum Sylejman Agës, në Gjakovë, më 24 mars, e cila mbante rreth 200 dorëshkrime dhe 1.300 libra të rrallë në turqishten otomane, arabishte dhe në Aljamiado (shqipe me shkronja arabe), si dhe arkivat rajonale të KBI-së me dokumente që datojnë qysh nga shekulli XVII.
- Shkatërrimi i Teqesë së Bektashinjve të Axhize Babës, në Gjakovë, që kishte njërin prej koleksioneve më të vlefshme të manuskripteve në regjion. Flaka i gllabëroi 250 dorëshkrime dhe më shumë se 2.000 libra të rrallë; katalogu i kompjuterizuar u djeg së bashku me bibliotekën. Teqenë e Bektashinjve e kanë djegur forcat serbe, në fillim të majit 1999, me granata të lansuara nga minahedhësit e krahut.
- Biblioteka e Atik Medresesë, në Pejë, është djegur - kanë mbetur vetëm disa pjesë të mureve të jashtme. Është shkatërruar krejtësisht koleksioni prej 2.000 librave të shtypur dhe reth 100 dorëshkrime.
- Shkolla teologjike nga periudha otomane, Atik Medreseja, në Ferizaj, po ashtu, është djegur plotësisht e mbeturinat janë rrafshuar me buldozher.

Sipas Riedlmayer-it, 209 xhami, 1/3 e të gjitha shtëpive të adhurimit në Kosovë, janë shkatërruar, djegur, çuar në ajër ose janë dëmtuar keq nga forcat serbe, gjatë pranverës së vitit 1999 dhe përgjatë verës së mëhershme. Ky shkatërrim përfshinte edhe qindra Kur'an-e të vjetër në dorëshkrim dhe dorëshkrime të tjera e libra religjiozë në bibliotekat e xhamive.

#### 4.6 Ambienti profesional dhe bibliotekar

Shoqata e Bibliotekistëve të Kosovës është rithemelur në shkurt të vitit 2000. SHBK-ja i organizon 300 profesionistë bibliotekarë dhe kryetar është zgjedhur Jetish Kadishani nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare. Anëtarësimi vjetor në te kushton 6 DM. Shoqata ka ndërmend rifillimin e botimit të informatorit të shtypur "Biblioteka", në mars të vitit 2000. I vetmi botim deri më tash është shtypur në vitin 1984. Shoqata ka vënë kontakte me shoqatat bibliotekare në Shqipëri, Kroaci, Slloveni, Maqedoni, Bosnjë dhe Itali.

Gazetat më të mëdha ditore që gjenden në Prishtinë janë: Rilindja, Bota Sot, Koha Ditore, Dardania, Zëri dhe Kosova Sot. Veprojnë shumë shtëpi botuese dhe është e pamundur që të dihet numri i tyre tash pas luftës. Tregun e librave e dominojnë romanet e huaja në përkthime të dobëta. Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës është active. Na kanë informuar se ekzistojnë 30 shtypshkronja, 3-4 prej tyre më të mëdha, e disa prej tyre veprojnë edhe si botues.

Sipas Tania Vivitsky-it, nga Fondacioni Sabre, librat në shqip mund të gjenden në Kosovë dhe në Shqipëri, me çmim mesatar rreth 4-5 marka për libër, plus transporti. Drejtori i Bibliotekës Komunale të Mitrovicës, z.Hajrulla Mustafa, na e tregoi listën e librave në shtyp të Shtëpisë Botuese "Buzuku", që përmbante 654 tituj. Blerja e nga një kopjeje të secilit libër arrin shumën e 5.536 DM.

Sipas z.Osmani, drejtor i Bibliotekës Publike të Gjilanit, Gjilani është qendër e intelektualëve të Kosovës. Qyteti është nikoqir i Panairit Vjetor të Librit, që organizohet nga biblioteka. Administrata rajonale e UNMIK-ut dha 4.400 DM për këtë panair në vjeshtën e vitit 1999. Aty morën pjesë 12 shtëpi botuese: 10 nga Kosova e 2 nga Shqipëria dhe Maqedonia. Panairi i librit, që zakonisht mbahet në maj, përfshinte edhe takimin e shkrimtarëve kosovarë.

Në korrik të vitit 1999, IRC-ja (International Rescue Committee) inicoi IPKO-në (Projekti i Internetit të Kosovës). Ideja ishte që të krijohej një server Interneti vetfinancues i cili do t'i shiste shërbime bashkësisë ndërkombëtare dhe do t'i ofronte lidhje falas shërbimeve civile. Me lejen e UNMIK-ut, IPKO-ja instaloi një antenë satelitore dhe një rrjet fiks - pa

tela, dhe filloi punën më 21 shtator 1999. Më 5 mars, IRC-ja lëshoi kontrollin dhe IPKO-ja zyrtarisht u shndërrua në OJQ të pavarur vendore. IPKO-ja ofron shërbime Interneti për 81 organizata në Kosovë dhe konsumatorët që paguajnë përfshijnë : UNMIK-un, OSBE-në, UNDP-në, WHO-në, Bankën Botërore, IOM-in, disa OJQ, internet-kafetë vendore dhe bizneset. Me fitimet nga këta konsumatorë, lidhje falas të Internetit jepen për 26 organizata vendore duke përfshirë: Universitetin e Prishtinës, Spitalin e Prishtinës, organizatat vendore të mediave, qendrat e përbashkëta të qasjes së OJQ-ve vendore, gazetarë dhe mjekë.

Televizioni i Kosovës (RTK) ka filluar me transmetim të programit të dielen më 19 shtator 1999, duke e shënuar një hap të rëndësishëm nga themelimi i shërbimit të pavarur transmetues publik në Kosovë. Programet ditore dy-orëshe përmbajnë lajme dhe programe në shqip dhe serbisht. Në të ardhmen do të shtohen programe edhe në gjuhët e minoriteteve tjera. Stacioni, po ashtu, shërben për transmetimin e programeve të UNMIK-ut.

Më 1 shkurt 2000, UNMIK-u lëshoi Rregulloren kundër Gjuhës së Urrejtjes, Rregullorja nr. 2000/4, me titullin "Mbi ndalimin e provokimit të dhunës, mospajtimit dhe jotolerancës nacionale, etnike, racore dhe fetare". Neni 1.1 thotë:

"Kushdo që publikisht provokon dhe përhap urrejtje, mospajtim ose jotolerancë në mes të grupeve nacionale, racore, fetare, etnike ose çfarëdo grupesh të tjera që jetojnë në Kosovë dhe me akte të tilla shqetëson rendin e ligjit, do të dënohet me gjobë ose me burgim për jo më gjatë se pesë vjet, ose me të dyjat".

OSBE-ja e sheh këtë rregullore si element kyç për një shoqëri demokratike, në të cilën duhet të bëhen diskutime civile dhe debate politike me përgjegjshmëri dhe pa dhunë. Rregullorja është diskutuar me Komisionin Këshilldhënës të Kosovës për Çështje Juridike dhe me Këshillin e Evropës dhe komentet e tyre janë reflektuar në ligj. Ligji përkon me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Janë parashikuar burgime deri në 10 vjet për ata që sistematikisht kryejnë akte të tilla dhe keqpërdorin pozitën e tyre. Kjo i shton një përgjegjësi të veçantë atyre që për shkak të pozitës, postit apo funksionit të tyre kanë mundësinë të komunikojnë me masa të mëdha njerëzish. Këtu përfshihen politikanët, udhëheqësit e komuniteteve, gazetarët, botuesit dhe mësimdhënësit. Rregullorja vlen për ndezjen e urrejtjes ndaj cilitdo grup. Në rast të dyshimit për ndezje të urrejtjes, duhen kryer hetime nga gjykatësi hetues. I takon prokurorit që të parashtrijë akuzën që lënda të arrijë para gjyqit. Në fund, gjyqi vendos mbi lëndën.

Në fjalimin e tij, më 16 shkurt 2000, ambasadori Daan Everts, Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë, tha:

"Ne nuk mund t'i tolerojmë fjalimet urrejtjenitëse askund në shoqëri - pa marrë parasysh a bëhen në radio, në klasë, në gazetë ose në ndonjë tubim politik. Për këtë shkak, edhe lëshimi i rregullores mbi fjalimet e urrejtjes këtë muaj është shumë i rëndësishëm. Para së gjithash, kjo rregullore do të shërbejë si masë frenuese" Ai, po ashtu, tha, "Ne nuk planifikojmë që të kemi ligj shtypi për mediat e shtypura; e vërteta është se jemi të përcaktuar MOS TË KEMI ligj të tillë. Kësaj i vjen era cenzurë... Kjo rregullore ka përdorim të kufizuar. Nuk është cenzuruese dhe nuk ka asgjë kundër raportimit kritik".

Organizata të rëndësishme ndërkombëtare, që i janë përkushtuar lirisë së të shprehurit, si Neni 19 dhe Fushata Globale për Shprehje të Lirë, kanë shprehur brengat se kjo masë shkon përtej restriksioneve në lirinë e të shprehurit që lejohet me ligjin ndërkombëtar. Sipas tyre, kjo është një zgjidhje e paqëlluar për problemin shumë kompleks të racizmit dhe jotolerancës në Kosovë.

#### 4.7 Përfundimet e përgjithshme

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare dhe bibliotekat e tjera janë duke u shkatërruar, është e rrezikuar ruajtja e trashëgimisë kulturore në formë të materialeve të shtypura dhe praktikisht nuk funksionojnë sistemet kombëtare për regjistrimin dhe shpërndarjen e dokumenteve. Janë zhdukur e, sipas të gjitha gjasave, edhe shkatërruar, pjesë të mëdha të koleksionit të vlefshëm të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare gjatë viteve 1990-1999.

Në pjesët rurale të Kosovës Qendrore dhe Perëndimore janë dëmtuar rëndë ndërtesat e bibliotekave. Bibliotekat në qytete kanë shpëtuar më mirë dhe janë në gjendje më të mirë në periudhën e pas luftës. Ndërtesat e bibliotekave akademike dhe bibliotekave të veçanta nëpër qytete në të shumtën e rasteve janë të paprekura, por koleksionet e tyre kanë vuajtur prej shkatërrimit, plaçkitjes dhe lënies pas dore. Ato që veprojnë mbajnë koleksione të vjetruara dhe u mungojnë pajisjet dhe teknologjia moderne.

Një pjesë e madhe e bibliotekave shkollore dhe publike kanë nevojë për rindërtim total të ndërtesave dhe koleksioneve. Janë djegur shumë kësi biblioteka, posaçërisht në fshatra. Tjerave u janë vjedhur ose shkatërruar koleksionet e librave e ato që ende veprojnë vuajnë prej efekteve të gati 10 vjetëve të lënies pas dore në furnizime.

Po kështu, shumë libra të bibliotekave janë djegur, së bashku me shtëpitë e pronarëve të tyre. Është vlerësuar se pothuajse gjysma e shumës së përgjithshme të librave nëpër biblioteka publike kanë humbur. Pjesa dërmuese e librave të mbetur janë ose të tejkaluar, ose të parëndësishme për banorët e vendit, për shkak të karakterit të tyre ideologjik, lingvistik ose etnik. Pothuajse të gjitha pajisjet janë larguar dhe shumica e stafit që aktualisht punojnë duhet t'i nënshtrohen trajnimit pas një periudhe të gjatë pa praktikë profesionale dhe arsimim sistematik.



Nuk ka kurrfarë bashkëpunimi, e as kontakti, ndërmjet profesionistëve të shumicës shqiptare dhe profesionistëve në enklava etnike të serbëve. Gjasat për pajtim ose, madje, edhe thjesht bashkëjetesë paqësore janë të vogla dhe të paqarta dhe parashikimet në këtë drejtim kryesisht varen nga zhvillimet e përgjithshme politike në Kosovë dhe në Ballkan.

Ekziston një nevojë e theksuar për nisma të koordinuara dhe komunikim më efikas në fushën e bibliotekave. Duhet bërë apo duhet të rikonfirmohen definicionet e obligimeve dhe detyrave "kombëtare" kosovare sa i përket ruajtjes dhe regjistrimit të mbarë trashëgimisë kulturore të botuar. Në përgjithësi, është e pranishme nevoja urgjente për dhoma të leximit, literaturë të fëmijëve dhe qasje në teknologji të re. Përkrahja ndërkombëtare, kur është fjala për financimin dhe ndihmën profesionale, është e domosdoshme për t'i rindërtuar bibliotekat dhe rrjetin funksional të tyre.

---

## 5. Rekomandimet për planin e zhvillimit afatshurtër dhe afatmesëm

### 5.1 Parimet dhe supozimet themelore

Njeriu mund të pyes me të drejtë se përse të mërzitemi me bibliotekat në një situatë në të cilën njerëzit, madje, janë pa shtëpi, nxemje, rrymë elektrike dhe të mirat e tjera vërtet themelore?

Shërbimet bibliotekare mund të jenë të rëndësishme dhe, pothuajse, fare lehtë të zbatueshme, një mjet në procesin e rindërtimit. Bibliotekat mundën, e pakta jo në një zonë si Kosova, të sigurojnë porta lokale të njohurive, të pasqyrojnë pluralitetin dhe llojllojshmërinë e shoqërisë dhe të mbështesin procesin e demokracimit. Në kryejën e veprimtarive të tilla, bibliotekat nxisin leximin, arsimimin dhe kulturën në një rajon, i cili ofron pak ose aspak dhe një numër të madh fëmijësh dhe të rinjsh. Në periudhat e tranzicionit ose të reformimit, cilësitë e tilla janë të një vlere të jashtëzakonshme.

Manifesti Publik i Bibliotekave i UNESCO-s ofron disa shenja të rëndësishme për interesin e shoqërisë lidhur me bibliotekat, rolin e tyre në shoqëri, proceset demokratike dhe tranzitore:

Liria, përparimi dhe zhvillimi i shoqërisë dhe i individëve janë vlera themelore njerëzore. Ato mund të arrihen vetëm përmes mundësisë së qytetarëve mirë të informuar për të ushtruar të drejtat e tyre demokratike dhe për të luajtur një rol aktiv në shoqëri. Pjesëmarrja konstruktive dhe zhvillimi i demokracisë varen nga arsimimi i kënaqshëm si dhe nga qasja e lirë dhe e pakufizuar e dijes, mendimit, kulturës dhe informacionit. Bibliotekat publike, portat lokale të dijes, sigurojnë kushte themelore për mësimin jetëgjatë, zhvillimin kulturor dhe kultural dhe vendim marrjen e pavarur të individëve dhe grupeve shoqërore".

Manifesti shpall besimin e UNESCO-s në bibliotekat publike si në "një forcë të gjallë për arsimimin, kulturën dhe informacionin, dhe si një veprues esencial për përfundimin e paqes dhe të mirëqenies shiptërore përmes mendjes së mashkullit e të femrës". Këto vlera themelore janë barabarësisht valide në relacion me bibliotekat akademike dhe ato speciale, të cilat, në mënyrë plotësuese, nxisin zhvillimin e shkencave dhe hulumtimit dhe, së këndejmi, përparimin e përgjithshëm shiptëror, kulturor, social e ekonomik dhe përparimin e shoqërisë.

Deklarata e IFLA-s mbi Bibliotekat dhe Lirinë Intelektuale thekson se, "angazhimi për lirinë intelektuale është një përgjegjësi thelbore e fushës së bibliotekave dhe informacionit" dhe se bibliotekat "ndihmojnë në ruajtjen e vlerave themelore demokratike dhe të të drejtave universale qytetare". Po ashtu, deklaron se bibliotekat duhet të "reflektojnë pluralitetin dhe llojllojshmërinë e shoqërisë" dhe se "duhet t'i vënë barabarësisht në dispozicion materialet, pajimet dhe shërbimet të gjithë shfrytëzuesve" pa diskriminim në bazë race, besimi, gjinie, moshe ose në bazë të çfarëdo arsyeje tjetër.

Manifesti i Bibliotekave Shkollore të UNESCO-s deklaron se "Bibliotekat shkollore sigurojnë informacione dhe ide që janë fundamentale për funksionimin e suksesshëm në shoqërinë e sotme të bazuar në informatat dhe dijen. Libraria shkollore pajis nxënësit me shkathtësi afatgjatë të të mësuarit dhe zhvillon imagjinatën, duke iu mundësuar atyre të jetojnë si qytetarë të përgjegjshëm".

Plani i mëposhtëm i propozuar, Projekti i Bibliotekave i Kosovës 2000+, bazohet në zbulimet e misionit tonë dhe në dokumentacionin e siguruar nga burime të tjera të përmendura në pjesët e mëparshme të këtij raporti.

Por, po ashtu, bazohet në supozimet dhe parimet e natyrës profesionale teorike dhe praktike që rrjedhin nga vëzhgimi i aktiviteteve bibliotekare të skicuara më lart:

#### 1. Qasja ndaj informative – parakusht për demokracinë

Të drejtat themelore njerëzore, liria e shprehjes dhe liria e qasjes ndaj informative, janë parakushte të demokracisë dhe qasja ndaj informatave është thelbore për proceset e rindërtimit dhe të tranzicionit.

#### 2. Bibliotekat si institucione aktive

Ambicia e këtij plani nuk është vetëm të rithemelojë gjendjen e bibliotekave në Kosovë siç ka qenë para prishjes dhe shkatërrimit të filluar më 1989. Po ashtu, do theksuar dhe rekomanduar shfrytëzimin e bibliotekave si

institucionre aktive, që nxisin vlerat, siç janë të drejtat e njeriut, demokracia, pjesëmarrja shoqërore dhe llojlojshmëria kulturore dhe për të stimuluar qarkullimin e përgjithshëm të informatave dhe, së këndejmi, ngritjen e nivelit të dijes.

### 3. *Bibliotekat – efikase dhe me vlerë ekonomike*

Bibliotekat janë mjete efikase dhe ekonomike për nxitjen dhe stimulimin e kulturës, arsimit dhe të hulumtimit, për ofrim të kënaqësisë dhe informatave të dobishme në kohën e lirë, dhe për të krijuar kushtet themelore për demokraci, zhvillim dhe pjesëmarrje. Në procesin e tranzicionit – si mjet i ndryshimit – këto cilësi janë, madje, edhe më shumë evidente: si një portë e hapur vendore e dijes pa obligime plotësuese lidhur me shfrytëzimin, bibliotekat ofrojnë një varg mundësish për individin dhe shoqërinë.

### 4. *Rrjetat dhe ankorimi vendor*

Rrjeti është mjeti më efikas për shfrytëzimin e burimeve ekzistuese dhe për të çliruar energjitë. Ankorimi vendor ose prania është thelbore për trajtimin e duhur të nevojave të tashme dhe specifike vendore.

### 5. *Bashkëpunimi dhe lidhmëria*

Masat e përbashkëta brenda sektorëve administrativ të arsimit dhe kulturës janë mënyra më racionale për shfrytëzimin e burimeve të kufizuara ekzistuese në të dy sektorët, për t'iu përshtatur nevojave të përbashkëta dhe për të përfituar nga ndihma e siguruar.

### 6. *Struktura dhe nisma*

Një qasje e gjithmbarshme kosovare dhe një koordinim është i domosdoshpëm për të siguruar zgjidhje afatgjata dhe efikase si dhe ndihmë efikase ndërkombëtare, por hapësira për iniciativa dhe angazhim vendor është një kusht për të siguruar ankorimin kosovar dhe për të stimuluar e angazhuar burimet më të mira.

### 7. *Platformat profesionale dhe fuqia e shembullit*

Ndërtimi i kapaciteteve profesionale vendore dhe i qendrave të decentralizuara të burimeve në rrethe dhe komuna ofron një ambient të zgjeruar profesional dhe një platformë për stimulimin e zhvillimit, kreativitetit dhe pjesëmarrjes. Po ashtu, themelon shembuj për inspirimin e të tjerëve.

### 8. *Ti-ja – një zgjidhje e shpejtë*

Teknologjia informative dhe interneti janë mjete thelbore dhe efikase që shpejt sigurojnë qasje ndaj sasive të mëdha të informatave dhe një mjet të komunikimit për shfrytëzuesit e bibliotekës dhe profesionistët.

### 9. *Informacioni e përparon pajtimin*

Iniciativat speciale janë të nevojshme për të nxitur pranimin e llojlojshmërisë kulturore, integrimin ose bashkekzistencën paqësore. Bibliotekat dhe qasja e rritur ndaj informatave mund të jenë mjete për të përforcuar vlerat e tilla dhe për të shpënë më tej një proces të pajtimitt në një perspektivë afatgjatë kohore.

### 10. *Zgjidhjet e menjëhershme me perspektivë*

Iniciativat e rindërtimit dhe të restaurimit brenda fushës së bibliotekës duhet të sigurojnë si një lehtësim të menjëhershëm e afatmesëm, ashtu edhe një zgjidhje të përkohshme, por, po ashtu, që ndërton themelet për një zhvillim afatgjatë.

### 11. *Administrata e vogël dhe efikasiteti i çmimeve*

Plani synon të arrijë efekte maksimale të ndihmës financiare dhe sigurim të ndihmës profesionale dhe, së këndejmi, të sugjerojë shfrytëzimin më të gjerë të strukturave ekzistuese dhe të organizimeve dhe një minimum të organeve administrative.

## 5.2 Projekti i Bibliotekave i Kosovës 2000+

Misioni i Bibliotekave i Kosovës propozon skicën e mëposhtme për rindërtimin dhe përforcimin e bibliotekave në Kosovë. Plani 3-4-vjeçar i veprimit përfshin projektet afatshkurta dhe përpjekjet për të nënvizuar strategjitë afatgjata për mëkëmbjen dhe zhvillimin e shërbimit bibliotekar.

Plani sugjeron formimin e një organi për një kohë të kufizuar, një Konzorcium të Bibliotekave të Kosovës, i cili do të përfshijë vepruesit vendës, donatorët e mëdhenj ndërkombëtar dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat ofrojnë këshillat dhe ekspertizën profesionale. Një plan veprimi më i përpunuar dhe më i hollësishëm mbi bibliotekat e Kosovës mund të zhvillohet brenda kësaj kornize.

Plani i veprimit përfshin vargun e propozuar të 11 programeve speciale që duhet të themelohen, secili prej tyre duke iu përgjigjur nevojave dhe aspekteve të ndryshme të aktiviteteve të bibliotekave, por, në përgjithësi, në përgjegjen ndaj një pikëpamjeje pak a shumë të kompletuar të ambientit të bibliotekave të Kosovës si tërësi:

1. Programi legjislativ dhe administrues
2. Programi i shërbimit të bibliotekave lëvizëse
3. Programi i rindërtimit
4. Programi i librit dhe i leximit
5. Programi i teknologjisë informative
6. Programi i zhvillimit dhe i trajnimit profesional
7. Programi i trashëgimisë kulturore
8. Programi i fëmijëve dhe i të rinjve
9. Programi i qasjes së hapur
10. Programi i mbështetjes së iniciativës
11. Programi i binjakëzimit

Programet e sugjeruara ndryshojnë për nga natyra dhe pesha financiare. Një vlerësim inicial dhe fare në vija të trasha i fondeve të nevojshme për masat themelore afatshkurta, arrinë shumën rreth 14 milionë DM.

Programi i parë përvijon bazat strukturale mbi të cilat procesi i rindërtimit mund të vendoset. Pesë programet, të cilat kërkojnë iniciativën më të pashtyeshme dhe pjesën më të madhe të financimit të jashtëm, janë Programi i shërbimit të bibliotekave lëvizëse, Programi i rindërtimit, Programi i zhvillimit dhe i trajnimit profesional, Programi i librave dhe i leximit dhe Programi i Teknologjisë informative. Ekzistojnë korelacione të rëndësishme midis këtyre programeve: Rindërtimi i ndërtesave është një detyrë afatgjate, e cila mund të marrë disa vite. Së këndejmi, shërbimet lëvizëse bibliotekare janë sugjeruar si një iniciativë kompenzuese pak a shumë e pashtyeshme. Ndërtesat, vetvetiu, nuk kanë vlerë pa librat, teknologji ose profesionistë të kualifikuar bibliotekarë.

Programi i trashëgimisë kulturore synon të sigurojë zgjidhje praktike për konservimet urgjente dhe nevojat e sigurisë. Programi për fëmijët dhe të rinjtë dhe Programi i qasjes së hapur janë të një natyre më shumë bibliotekare politike me qëllim të reformimit dhe të përforsimit të disa aspekteve të rëndësishme të rolit shoqëror të bibliotekave. Dy programet e fundit sugjerojnë krijimin e mjeteve specifike për sigurimin dhe nxitjen e angazhimeve vendore dhe të pjesëmarrjes.

#### 5.2.1 Konzorciumi i Bibliotekave i Kosovës

Ekziston një nevojë e gjithmbarshme për të bashkërenditur iniciativat vendore dhe ndërkombëtare, të cilat trajtojnë nevojat e bibliotekave të Kosovës, në përgjithësi. Një Konzorcium i Bibliotekave i Kosovës duhet të jetë pika fokale që lidh interesat ndërkombëtare dhe vendore. Duhet të propozojë, të bashkërendisë dhe të mbikqyrë veprimtaritë gjatë një periudhe prej tre deri në katër vjet dhe:

- Të ndërmarë iniciativa për të bërë një plan më të përpunuar të veprimit për bibliotekat e Kosovës;
- Të identifikojë donatorët potencial në radhën e agjencive të ndihmave, fondacionet qeveritare dhe ato private;
- Të themelojë partneritetin bashkëpunues me organizatat e interesuara përkatëse;
- Të zhvillojë dhe realizojë projektet në pajtim me planet;
- Të sigurojë se burimet financiare, teknike dhe njerëzore shpenzohen në pajtim me vendimet;
- Të vlerësojë veprimtaritë e gjithmbarshme në një mënyrë sistematike;
- Të mbledh dhe të shpërndajë përmes publikimit apo sipas kërkesës informacion mbi zhvillimet bibliotekare të Kosovës.

KBK-ja duhet të jetë një organ formal vendimmarrës i Projektit të Bibliotekave të Kosovës 2000+. Duhet të përfshijë përfaqësuesit e të gjithë aksionarëve të rëndësishme, vepruesve vendor, donatorëve ndërkombëtarë dhe organizatave konsultative, qoftë të angazhuar në pajtim me detyrat mandatore ose të angazhuar si partnerë kryesor financiar. Aksionarët e mëposhtëm, krahas të tjerëve, duhet, si shtesë, të marrin pjesë. UNMIK-u, institucionet dhe organizatat relevante të Kosovës, UNESCO-ja, COE-ja dhe IFLA.

KBK-ja duhet të emërojë një ekspert ndërkombëtar që përfaqësuesit e tij të jenë në Prishtinë. Ky ekspert mundet ose të jetë i punësuar drejtëpërdrejtë nga administrata e UNMIK-ut ose nga vet konzorciumi. Nëse sigurohet pozita e ekspertit për një periudhë 3-4-vjeçare, shpenzimet e llogaritura do të ishin rreth 450.000 DM. Përgjegjësia kryesore për këtë pjesë të planit qëndron në UNESCO-n, CoE-në dhe IFLA-n.

### 5.3 Programet speciale

#### 5.3.1 Programi legjislativ dhe administrues


Ky program synon t'i krijojë ose t'i sigurojë kushtet themelore në kuptimin legjislativ apo rregulloret dhe strukturën administrative të një sistemi bashkëkohor të bibliotekave në Kosovë.

Legjislacioni përkatës kosovar ose duhet të revidohet, bazuar në legjislacionin e ish Jugosllavisë, ose duhet të krijohet mbi bazat e nevojave të tashme dhe të ardhme. Kompetenca e ekspertëve legjislativ të Këshillit të Evropës duhet të shfrytëzohet. Është sugjeruar se aksionet e mëposhtme duhet të ndërmirren sa më shpejt të jetë e mundur:

1. Revidimi i Ligjit të bibliotekarisë;
2. Revidimi i të Drejtës së botimit;
3. Revidimi i Ligjit mbi depozitimin e ligjshëm;
4. Përfshirja e minimumit të standardeve bibliotekare ose formulimeve në të gjitha nivelet e legjislacionit të arsimit.

Projektet duhet të përpunohen, debatohen dhe miratohen brenda strukturës administrative të skicuar më poshtë para adoptimit.

Figura 5. Kosova library network



Administrata e infrastrukturës bibliotekare të ardhshme të Kosovës mund të bazohet në elementet themelore të mëposhtme:

1. Një Këshill i Bibliotekave i Kosovës, i themeluar për t'i ushtruar detyrat e mëposhtme:
  - T'i jep këshilla për organet qeveritare mbi bibliotekat dhe çështjet e informacionit dhe
  - Të bëjë rekomandime të organet përkatëse lidhur me projektet dhe shpenzimet.
2. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare si një qendër burimi kombëtar që siguron:
  - Shërbimet qendrore teknike, siç është katalogjizimi dhe klasifikimi;
  - Shërbimet qendrore të internetit;
  - Një version rezervë kombëtar të koleksioneve të librave;
  - Kompetencë profesionale dhe trajnim;
  - Qendër të pagesës së të drejtave të autorësisë dhe

- Qendër të librit.

3. Një numër të qendrave rajonale, të cilat duhet t'i mbështesin të gjitha kategoritë e bibliotekave brenda rretheve të tyre me:

- Nisma dhe insipirim lidhur me zhvillimet bibliotekare;
- Përkrahje përmes sigurimit të librave, këshillave dhe ndihmës teknike bibliotekare dhe
- Paraqitje të nevojave vendore dhe të interesave locale në nivel kombëtar.

Këshilli i Bibliotekës i Kosovës duhet të përfshijë dy përfaqësues të Departamentit të Kulturës e të Arsimit të Strukturës së Përkohshme të Përbashkët, dy përfaqësues të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare dhe të bibliotekave të tjera speciale ose akademike, një përfaqësues të secilës bibliotekë rajonale dhe një përfaqësues të Konzorciumit të Bibliotekës së Kosovës.

Struktura administrative tradicionale dhe gjerësisht e përdorur brenda Kosovës përfshin pesë rrethe kryesore: Prishtinën, Mitrovicën, Gjilanin, Prizrenin dhe Pejën, por ky plan sugjeron përdorimin edhe të dy rretheve. Bazuar në konsideratat strategjike profesionale bibliotekare dhe gjeografike, është sugjeruar të përfshihen dy rrethe më shumë për rreth qytetit të Gjakovës dhe Ferizajt, që, të dyjat, kanë, krahasimisht, pajime të mira bibliotekare dhe personel profesional. (Shih fig. 6).

Si një zgjidhje e përkohshme, po ashtu, është sugjeruar që bibliotekat brenda zonave etnike serbe të formojnë një rrjet të ndarë bibliotekar, të bazuar në Leposaviq, duke përfshirë të gjitha komunat e dominuara nga serbët dhe të lidhura me bibliotekat e serbëve në fshatra për gjatë Kosovës. Ky rrjet, po ashtu, duhet të përfaqësohet në Këshill.

Përgjegjësia kryesore për nismat brenda programit qëndron në Ministrin e Kulturës dhe administratën qendrore të UNMIK-ut/SPPA.

### 5.3.2 Programi i shërbimit të bibliotekave lëvizëse

Programi i shërbimit të librit lëvizës duhet të krijohet duke përfshirë dy elemente qendrore:

- Bibliotekat shëtitëse (koleksionet transportable të librave) në të gjitha komunat dhe
- 8 libërbusë me seli në qytetet e mëposhtme: Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren, Ferizaj, Gjakovë dhe Leposaviq.

Bibliotekat shetëtiëse duhet të përbëhen në minimum nga 10 koleksione transportable të librave në secilën komunë ( 29 komuna x 10 depotë x 50 libra në secilën depo = 14.500 libra). Sipas një çmimi të llogaritur për libër 30.00 DM shpenzimet për koleksionet do të jenë rreth 435.000 DM. Kjo shumë nuk përfshin investimet në pajisjet, siç janë pakot e transportimit etj.

Sipas planeve vendore, pakot e bibliotekave duhet të qarkullojnë ndërmjet shkollave vendëse, degëve të bibliotekave, kopshtoret, fabrikat dhe institucionet e tjera përkatëse me qëllim të rritjes së leximit të librave, qasjen në gjuhën dhe kulturën dhe sigurimin e argëtimit, leximit dhe njohurive përkatëse. Një komision shkrimtarësh, bibliotekarësh dhe dijetarësh duhet të marrë vendime lidhur me përmbajtjen e depove.

Figure 6. Rrethet e Kosovës

Rrethet e tashme administrative:		Rrethet e propozuara bibliotekare:		
Emri i rrethit	Komunat e përfshira	Emri i rrethit	Komunat e përfshira	
Mitrovicë	Mitrovicë/Mitrovica	Mitrovice	Mitrovicë/Mitrovica	
	Skënderaj/Srbica		Skënderaj/Srbica	
	Vushtri/Vucitrn		Vushtri/Vucitrn	
	Leposaviq/Leposavic		Leposaviq	Leposaviq/Leposavic
	Zveçan/Zveçan		Zveçan/Zveçan	
	Zubin Potok/Zubin Potok		Zubin Potok/Zubin Potok	
Pejë	Pejë/Pec	Pejë	Pejë/Pec	
	Istog/Istok		Istog/Istok	
	Klinë/Klina		Klinë/Klina	
	Gjakovë/Djakovica		Gjakovë	Gjakovë/Djakovica

	Deçan/Deçani		Deçan/Deçani
Prizren	Rahovec/Orahovac		Rahovec/Orahovac
	Malishevë/Malisevo		Malishevë/Malisevo
	Prizren/Prizren	Prizren	Prizren/Prizren
	Suharekë/Suva Reka		Suharekë/Suva Reka
	Dragash/Gora		Dragash/Gora
Prishtinë	Prishtinë/Pristina	Prishtinë	Prishtinë/Pristina
	Podujevë/Podujeva		Podujevë/Podujeva
	Glllogovc/G logovac		Glllogovc/Glogovac
	Obiliq/Obilic		Obiliq/Obilic
	Fushë Kosovë/Kosovo Polje		Fushë Kosovë/Kosovo Polje
	Lipjan/Lipljan		Lipjan/Lipljan
	Shtime/Stimlje	Ferizaj	Shtime/Stimlje
Gjilan	Ferizaj/Urosevac		Ferizaj/Urosevac
	Shterpcë/Strpce		Shterpcë/Strpce
	Kaçanik/Kacnik		Kaçanik/Kacnik
	Gjilan/Gjilane	Gjilan	Gjilan/Gjilane
	Viti/Vitina		Viti/Vitina
	Novobërdë/Novo Brdo		Novobërdë/Novo Brdo
	Kamenicë/Kosovska Kamenica		Kamenicë/Kosovska Kamenica

Libërbusët do të ndahen në bibliotekat qendrore rajonale, të cilat, po ashtu, korrespondojnë me strukturën rajonale dhe administratën e rrjetit bibliotekar. Secili libërbus do të ketë kapacitet prej përafërsisht 2000 librash dhe të materialit tjetër dhe do të jetë mjeti kryesor për shërbimin bibliotekar të shpejtë dhe të decentralizuar anë e mbanë Kosovës. Një libërbus kushton përafërsisht 400.000 DM (8 libërbus X 400.000 DM bëjnë 3200.000 DM). Shpenzimet për libër do të jenë rreth 480.000 (8x 2000 x30). Investimet totale për 8 libërbus do të jenë rreth 3.680.000 DM, duke përfshirë pajimet shitesë.

Me një kapacitet të zakonshëm të punës të personelit, secili autobus do të jetë në gjendje t'i shërbejë përafërsisht 100 bashkësi vendore çdo muaj dhe libërbusi do të jetë në gjendje t'u shërbejë qëllimeve të tilla përafërsisht 10-11 herë në vit. Ekziston nevoja për një vozitës, dy bibliotekist dhe për pak ndihmë administrative për secilin autobus.

Libërbusi i lokalizuar në Leposaviq duhet të ketë një përgjegjësi speciale në shërbimin për bashkësitë vendore gjuhësore serbe dhe duhet t'i ndajë burimet e tij ndërmjet enklavës serbe në veri dhe bashkësive vendore gjuhësore serbe anë e mbanë Kosovës.

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e këtij programi i takon UNMIK-ut/SPPA-së dhe Konzorciumit të Bibliotekës së Kosovës, derisa Biblioteka Kombëtare e Kosovës në bashkëpunim me qendrat rajonale do ta kishte përgjegjësinë për veprimet praktike.

### 5.3.3 Programi i rindërtimit

Duhet të krijohet një program, i cili ka për qëllim ta sigurojë financimin e nevojshëm për rindërtimin e bibliotekave të rrënuara apo të dëmtara anë e kënd Kosovës. Programi duhet të përqëndrohet në pajimet themelore bibliotekare, siç është ndërtimi, orenditë dhe pajimet e tjera. Duhet, po ashtu, të përfshijë mundësinë e sigurimit të ndihmës së menjëhershme ose financimin, p.sh., për gjeneratorët ose nxemjen.

Programi duhet të inicohet në bashkëpunim me disa agjenci të mëdha ndërkombëtare të ndihmave dhe të mbështetet në përvojën e fituar nga UNESCO-ja në rindërtimin e

shkollave filllore dhe të mesme të Kosovës.

65 ndërtesa publike bibliotekare kanë nevojë për rindërtim të plotë dhe shumë të tjera kanë nevojë për mëkëmbje për shklak të dëmtimeve ose shpërfilljes. Fillimisht është propozuar se një shumë prej 4 milionë DM është ndarë për rindërtimin dhe masat e riparimit.

Në fazën fillestare, programi duhet të:

- Identifikojë partnerët e mundshëm dhe donatorët;

- Përpilojë informacionin dhe të sigurojë vlerësimin e hollësishëm të shkatërrimit dhe dëmtimin e bibliotekave kosovare dhe të skicojë një plan të të gjithmbarshëm të veprimit;
- Ta marrë përgjegjësinë për riparimin e bibliotekave të Kosovës, duke përfshirë edhe rindërtimin e ndërtesave të reja, ndreqjet dhe rinovimet e objekteve ekzistuese dhe sigurimin e orendive dhe të pajtimeve teknike dhe të
- T'u japë përparësi për bibliotekat qendrore rajonale.

Përgjegjësia kryesore për këtë program i mbetet Konzorciumit të Bibliotekave së Kosovës dhe UNMIK-ut.

#### 5.3.4 Programi i librit dhe i leximit

Një nga arsyet për nivelin e lartë të konfliktit në shoqërinë e Kosovës midis grupeve etnike është mungesa e njohurive lidhur me kulturën dhe historinë e grupeve të tjera. Me një rritje të përgjithshme të nivelit të gjithmbarshëm të njohurive mbi shoqërinë, mundësitë e të kuptuarit dhe të pajtimit mund të rriten. Është një qasje afatgjate për të ndryshuar shprehitë e leximit në një shoqëri. Në Portugali, një qasje e tillë është shfrytëzuar për të ndryshur shprehitë e leximit që nga viti 1989 me një investim sistematik në bibliotekë publike, librat dhe leximin.

Duhet të inicohet një program i cili synon prodhimin e librave dhe shpërndarjen e librave në Kosovë, duke përfshirë aktivitete që:

- Stimulojnë prodhimin e librave në gjuhën shqipe, serbe dhe turke. Programi duhet të përfshijë aktivitete në fushat e mëposhtme: autorësinë, publikimin, libraritë, marketingun e literaturës në media (TV-ja, të përditshmet, radio, interneti) revistat letrare, seminarët dhe punëtoritë për grupet përkatëse;
- Përfaqësojnë një program donatorësh të organizuar e sistematik me përqendrimin kryesor në librat në gjuhën angleze;
- Përfaqësojnë një përkthim sistematik në shqip të librave, veçanërisht për fëmijë dhe librave edukativ nga autorët e shquar të huaj dhe shtëpitë botuese;
- Krijojnë një Qendër për librin në Bibliotekën Kombëtare me detyrën që të organizojë veprimtari siç janë përmendur më lart dhe, po ashtu, libra përrallash, ekspozita dhe aktivitete në Internet që mund të nxisin leximin dhe kornizën e përgjithshme në Kosovë për prodhimin e librit.
- Organizojnë punëtoritë e shkrimtarëve të ri me qëllim të inspirimit të talenteve të reja për t'u bërë shkrimtarë dhe të mbështesë panairin vjetor të librit në Gjilan

Në fazën fillestare ambicia duhet të jetë të sigurojë së paku 50.000 libra të reja si në gjuhët vendore ashtu edhe në ato të huaja për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare. Nëse çmimi mesatar i një libri llogaritet të jetë 30,00 DM (50.000x30.000 DM), çmimi, vetvetiu, do të jetë deri në 1, 5 milionë DM.

Për më shumë, sigurimi i 10.000 librave të reja për secilën prej 8 bibliotekave rajonale qendrore (8x10.000x30 DM) do të kushtonte 2, 4 DM.

Një ambicie afatgjatë mund të jetë që të zëvendësohet numri i llogaritur i librave të bibliotekave të rrënuara apo, ndryshe, të humbura në Kosovë (900.000 x 30DM), që do të arrinte shumën prej 27 milionë DM.

Shpenzimet për transportimin dhe punën teknike librare (katalogizimi, klasifikimi dhe, në disa raste, lidhja) duhet t'i shtohen këtyre shpenzimeve të thjeshta të sigurimit.

Përgjegjësia kryesore për iniciativat brenda këtij programi i mbetet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare dhe programi duhet të përfshijë Konzorciumin e Teksteve Shkollore dhe palët e tjera të interesuara, siç është Sabre Foundation.

#### 5.3.5 Programi i Teknologjisë Informative

Bashkësia bibliotekare e Kosovës është, pak a shumë, pa teknologji informative në lidhje me hardware dhe software si dhe me zotësinë, shkathtësitë dhe përvojën. Mund të parashihet se investimet në TI do të jenë veçanërisht me çmim të lartë dhe do të ofrojnë shërbime të të decentralizuara dhe të shpërndarjes të cilësisë së lartë në pikat e qasjes anë e mbanë vendit.

Programi synon në afat të gjatë të sigurojë sisteme të integruara bibliotekare dhe shërbime të bazuara në teknologji informacioni në të gjitha bibliotekat e Kosovës, publike si dhe ato akademike.

Në fazat fillestare, programi, përmes bibliotekave publike, duhet të synojë që qytetarëve t'u ofrojë:

- Qasje të lirë në Internet për të gjithë në objektet e bibliotekës publike;
- Sistem të TI-së vendore administrative bibliotekare që ka të bëjë me përdorimin e katalogut, huave dhe punëve të

tjera administratave;

- Një sistem të rrjetit elektronik bibliotekar, që iu ofron qasje të gjitha bibliotekave në sistem për një katalog të përbashkët kombëtar, një sistem të porosisë për pajimet e rrjetit ndërbibliotekar dhe të huazimit.

Programi mund të ecën përpara përmes dy fazave:

1. Biblioteka Kombëtare dhe bibliotekat rajonale qendrore duhet të përfshihen dhe lidhen (2001-2002) dhe
2. Pjesa tjetër e komunave duhet të përfshihet dhe lidhet (2003-2004).

Në fazën fillestare shpenzimet e thjeshta për të siguruar qasjen Internetit përmes blerjes së prej 10 deri 15 kompjutorëve për secilën prej 8 bibliotekave qendrore rajonale do të arrijnë shumën prej 320.000 deri 480.000 DM (8x10-15x4.000). Këtyre shumave duhet t'i shtohet e pakta 50 % për shpenzimet e transportit, kabllove, software, arsimimin etj., që ngrisin shumën e nevojshme prej 480.000 deri në 720.000 DM.

Nëse të gjitha bibliotekat e Kosovës dhe disa biblioteka më të mëdha të kombinuara duhet të kenë nga 5 kompjutorë secila, shpenzimet do të ishin së paku 12 milionë DM (5x 6.000 DM x 400) + 50 % = 18 milionë DM.

Për t'i zbatuar sistemet e integruara bibliotekare në Kosovë, bibliotekat do të kërkonin një hulumtim shumë më të hollësishëm dhe nuk është e mundur për të llogaritur shpenzimet e një mase të tillë brenda kornizës së këtij raporti.

Përgjegjësia kryesore e këtij programi i mbetet Bibliotekës Kombëtare e Universitare në bashkëpunim të ngushtë me një grup ekspertësh të zgjedhur nga jashtë. Një kompani e madhe e TI-së - në Evropën Perëndimore ose Shtetet e Bashkuara duhet, nëse është e mundur, të përfshihet në sponsorizimin e këtij programi.

#### 5.3.6 Programi i zhvillimit profesional dhe i trajnimit

Mungesa e profesionistëve kompetentë bibliotekarë është një nga pengesat më të mëdha e të drejtpërdrejta për zhvillimin e mëtejshëm të bibliotekave në Kosovë. Një vëmendje e veçantë duhet të vihet në arsimimin dhe trajnimin profesional. Pa këtë, zhvillimi i pjesës më të madhe të iniciativave dhe programeve për bibliotekat e Kosovës i shtohet rrezikut për të mos qenë efikas.

Një program sistematik duhet të zbatohet për të rikrijuar arsimimin profesional dhe trajnimin në Kosovë. Qëllimi afatgjatë i programit duhet të jetë sigurimi i arsimimit të bibliotekistëve të ri, që mund të bëhen forcë punuese në bibliotekat e Kosovës në 20-30 vjetët e ardhshme. Në plan afatshkurtër, programi duhet:

- Të identifikojë gjasat e trajnimit për personelin, si në Kosovë, ashtu edhe jashtë;
- Të hulumtojë mundësitë për krijimin e një arsimimi profesional formal brenda Kosovës;
- Të rihap lidhjet profesionale kosovare me bashkësitë profesionale ndërkombëtare, duke përfshirë anëtarësitë e organizatave ndërkombëtare profesionale.
- Të vë dialogun dhe bashkëpunimin midis profesionistëve bibliotekar në Kosovë dhe në vendet fqinje;
- Të nxis dhe përkrah vijimin e personelit të Kosovës në konferencat ndërkombëtare dhe
- Të sigurojë kurse të freskimit dhe të vazhimit të arsimimit për punëtorët profesionistë.

Kurset dhe programet mund të zhvillohen dhe zbatohen përmes bashkëpunimit midis ekspertëve vendas kosovarë, fakulteteve të shkencave bibliotekare dhe informative ose shkollave në vendet fqinje, p.sh., në Slloveni (Lubjanë) ose Kroaci (Zagreb), dhe AEBEIH-i (Asociacionin Evropian për Biblioteka dhe Edukim Informativ dhe Hulumtim). Efekti kryesor edukativ duhet të jepet në rrafsh vendor ose në Lubjan apo Zagreb, duke përfshirë edhe ekspertët nga institucionet edukative të Shkencave Bibliotekare dhe Informative në Evropë.

Nevoja e llogaritur kosovare për profesionistë bibliotekash është përafërsisht 200. Programi duhet të synojë drejt edukimit të këtij numri në një rrjedhë kohore 10-vjeçare me 20 bibliotekist të rinj në çdo vit duke filluar më 2003. Përgjegjësinë kryesore për iniciativën duhet ta mbajë Ministria e Kulturës dhe AEBEIH-i.

#### 5.3.7 Programi i trashëgimisë kulturore

Një pasojë dramatike të njerëzve të goditur nga lufta dhe konfliktet është dëmtimi dhe shkatërrimi i dokumenteve dhe objekteve të trashëgimisë kulturore. Kosova është karakterizuar nga lufta dhe konfliktet për një periudhë të gjatë të kohës. Konfliktet e reja mund të lindin dhe është urgjente për të siguruar se trashëgimia kulturore e përfaqësuar nga librat, dokumentet dhe një varg i gjatë i objekteve të tjera mbahen të sigurta për të ardhmen. Veprimtaritë politike, kulturore dhe religjioze varen nga kujtesa dhe dokumentet.

Një program i cili synon ta ruajë dhe ta sigurojë trashëgiminë kulturore kosovare duhet të inicohet me qëllim të:



- Përpilimit të inventarëve të pasurisë kulturore në nivel institucional, rajonal dhe kombëtar;
- Identifikojë projektet afatshkurta për mbrojtjen emergjente të pasurisë së rrezikuar;
- Krijojë lidhje dhe partneritet me institucionet përkatëse jashtë që mbajnë koleksione që kanë të bëjnë me Kosovën;
- Fillojë digjitalizimin e trashëgimisë kulturore kosovare të shtypur apo të shkruar;
- Ripërtërijë prodhimin e bibliografisë kombëtare të Kosovës dhe
- Krijojë plane emergjente dhe trajnim të personelit në rast të gatishmërisë ndaj rrezikut dhe rimëkëmbjes për institucionet përkatëse.

Një projekt i digjitalizimit duhet të inicohet me qëllim që të sigurohet një ruajtje sistematike dhe dokumentacion i trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe një qasje e hapur e shpërndarjes përmes Internetit. Fokusi i veçantë duhet të jetë në përkufizimin e gjerë të trashëgimisë kulturore duke përfshirë dokumentet kulturore, fetare, historike dhe etnike, njësitë, imazhet, tingujt e tjerë.

Gjuha shqiptare dhe serbe duhet të përfaqësohen dhe projektet dhe duhet të synojnë një përfshirje të plotë të të gjitha fushave të mundshme.

Shpërndarja e gjerë e materialit në Internet, deri në një masë, do të kompenzojë dëmet e shkaktuara në tekstet e rëndësishme dhe në dokumentacionin gjatë represionit dhe luftës. Mungesa e materialëve duhet të digjitalizohet jashtë Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me muzetë përkatëse, bibliotekat dhe institucionet në vendet e huaja.

Projekti duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Arkivin Kombëtar të Kosovës dhe Muzeun Kombëtar të Kosovës dhe një Komision i ekspertëve shqiptarë e serb duhet të krijohet me detyrën që të sigurojë kualitet dhe autenticitet të materialeve të digjitalizuara dhe të shpërndara në Internet. Projekti duhet të udhëhiqet në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët ndërkombëtar.

Përgjegjësia kryesore për këtë program i takon Ministrisë së Kulturës në Kosovë.

#### 5.3.8 Programi i fëmijëve dhe i të rinjve

Një program biblioteke kushtuar fëmijëve dhe të rinjve, që siguron shërbime edukative, argëtuese dhe, madje, psikosociale, duhet të krijohet. Shumë fëmijë kosovarë ende janë duke lënguar nga stresi pastraumatik dhe ankthi për shkak të përjetimeve të cilave u janë ekspozuar gjatë luftës. Përqindja e atyre të moshës 18 dhe 20-vjeçare të popullatës kosovare është vërtet e lartë krahasuar me vendet e tjera evropiane apo rajonet. Tash, ekzistojnë fare pak, nëse ekziston ndonjë, trajtim për ato grupmosha në nivel vendor. Shumë institucione kulturore vendore janë mbyllur ose shkatërruar gjatë luftës dhe ende nuk janë duke funksionuar.

Programi duhet të përfshijë iniciativa të ndryshme për të krijuar dhe forcuar shpehitë e leximit të fëmijët në një moshë të re dhe për të stimuluar imagjinatën dhe kreativitetin e fëmijëve dhe të të rinjve nëpërmjet:

- Zhvillimit të bibliotekave adekuate të fëmijëve ose të shërbimeve në bibliotekat komunale;
- Nxitjes së bashkëpunimit me mësuesit vendor të shkollave fillore e të mesme për të trajtuar nevojat e fëmijëve dhe të të rinjve;
- Sigurimit të librave për fëmijët në bibliotekat e tilla si në gjuhët e huaja për ndihmën e drejtëpërdrejtë, ashtu edhe nëpërmjet nxitjes së përkthimeve në gjuhët përkatëse;
- Krijimit të bibliotekave të vogla të lodrave, koleksioneve të lodrave në dispozicion për hua, të cilat mund të siguronin vërtet mjete të lira e efikase për qëllime edukative, psikosociale dhe rekreative në bashkësitë vendore kosovare, duke mbështetur iniciativat e tjera të një natye më formale dhe të komplikuar. Ofrimi i ngjarjeve kulturore, të cilat mund të inskenohen nëpër biblioteka, p.sh., shfaqje teatrore apo muzikore, ekspozita të vogla, shfaqje filmash ose rrëfime tregimesh;
- Sigurimit të librave dhe revistave në gjuhët vendore e të huaja të drejtuara nga njerëzit e ri;
- Sigurimit të hapësirës dhe pajimeve për zhvillimin e klubeve e të shoqatave dhe
- Sigurimit të qasjes së papagesë në Internet, duke përfshirë këtu ndihmën, orientimin dhe trajnimin.

Përgjegjësia kryesore për iniciativat brenda këtij programi qëndron në Konzorciumin e Bibliotekave të Kosovës dhe në Këshillin e Bibliotekave të Kosovës.

#### 5.3.9 Programi i qasjes së hapur

Një shoqëri e hapur, e karakterizuar nga një publik i përgjithshëm i arsimuar dhe i informuar mirë me një qasje të gjerë ndaj informacionit publik, është parakusht për një shoqëri demokratike, ashtu siç është edhe dialogu midis niveleve të ndryshme dhe segmenteve në shoqëri. Një përqëndrim i veçantë në ndarjen etnike është i nevojshëm në Kosovë. Bibliotekat e Kosovës kanë mundësi të veçanta dhe përgjegjësi në këtë fushë.

Qasja e plotë e publikut ndaj materialit bibliotekar në Kosovë, madje edhe para luftës, ka qenë e kufizuar krahasuar me qasjen e përgjithshme ndërkombëtare në bashkësinë e gjerë ndërkombëtare. Duhet, në përgjithësi, të ekzistojë një qasje ndaj materialeve bibliotekare dhe shërbimeve dhe kjo qasje e hapur nuk duhet, nëse është e mundur, të jetë e kufizuar nga gjendja financiare e shfrytëzuesit apo ndonjë pengesë tjetër fizike benda bibliotekës.

Programi i qasjes së hapur duhet të nxis, në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse që është e mundur, qasjen universale dhe referencën anë e kënd botës si ndaj trashëgimisë së shkruar ashtu edhe ndaj informacionit të përmbajtur në mediat e reja. Programi, së këndejmi, duhet të hulumtojë dhe ofrojë zgjidhje për çështjet e sigurisë që rrjedhin nga ndryshimet në shërbimet. Masat e sigurisë duhet, ndonjëherë, të merren me qëllim të sigurimit të materialit dhe të parandalimit të vjedhjes apo të dëmtimit. Masat e mëposhtme duhet të ndërmerren:

- Koleksionet duhet të jenë të hapura për publikun në biblioteka, kur ato janë të mbyllura;
- Orët e punës duhet të zgjaten kur kjo është e mundur;
- Departamentet e fëmijëve dhe të rriturve duhet të organizohen afër njëri-tjetrit dhe jo në objekte të ndara;
- Krijimi i hapësirës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të leximit;
- Qasja e gjerë ndaj informacionit publik dhe informacionit nga organizatat politike, sociale, etnike dhe fetare duhet të ofrohet nëpër objektet e bibliotekave si pjesë e procesit demokratizues;
- Ofrimi i shërbimeve multinacionale dhe
- Pikat e qasjes Internetit duhet të jenë në dispozicion për fëmijët dhe të rriturit pa pagesë brenda objekteve të bibliotekave.

Këto masa duhet të merrren në tri nivele:

- Ndryshimi i qëndrimeve përmes fushatave, punëtorive dhe diskutimeve;
- Nxitja e riorganizimit të objekteve përmes ndihmave dhe këshillimeve vendore dhe
- Siguria se planifikimi i objekteve të reja të bibliotekave merr parasysh faktorët e sipërpërmendur.

Përgjegjësia kryesore për iniciativat brenda këtij programi qëndron në Konzorciumin e Bibliotekave të Kosovës dhe në Këshillin e Bibliotekave të Kosovës.

#### 5.3.10. Programi i përkrahjes së nismës

Duhet të krijohet një program për t'i përkrahur nismat dhe pjesëmarrjen vendore. Duhet të synojë të themelojë organe që mund të ofrojnë këshillë, orientim dhe këshillim, duke përfshirë edhe përvojën ndërkombëtare. Për më shumë, duhet të përkufizojë, të zbatojë dhe të udhëheqë fondet, të cilat mund të ofrojnë mbështetjen financiare për iniciativat vendore dhe iniciativat që iu shërbejnë qëllimeve të përbashkëta. Duhet të jepen ndihma në bazë të konkurimeve dhe rezultateve të vëzhguara dhe të dokumentuara. Qëllimet janë që të nxiten e shpihen më tutje iniciativat vendore dhe të sigurohen nxitet për bashkëpunimin, bashkërenditjen dhe pjesëmarrjen vendore në çështjet e politikës bibliotekare dhe zhvillimin profesional. Programi mund të përfshijë dy fonde:

- Fondi i Iniciativës bibliotekare, që përkrah nismat vendëse/kopmunale për të rindërtuar dhe zhvilluar shërbimet vendore bibliotekare. Ndihmat duhet t'i jepen atyre që i meritojnë ato përmes iniciativës, përkushtimit dhe planifikimit profesional dhe
- Fondi i Qëllimeve të përbashkëta që siguron fonde për zhvillimin e projekteve, bashkërendimin e iniciativave, pjesëmarrjen në bashkëpunimin dhe përfaqësimin ndërkombëtar profesional, kurset dhe konferencat, komisionin e punës dhe publikimet profesionale.

Përgjegjësia kryesore për këtë program qëndron në Këshillin e Bibliotekave të Kosovës, në bashkëpunim me Konzorciumin e Bibliotekave të Kosovës.

#### 5.3.11 Programet e binjakëzimit

Duhet të krijohet një program për t'i siguruar lidhjet e drejtëpërdrejta midis bibliotekave të veçanta kosovare dhe komunave me institucionet paralele të jashtme dhe organet administrative në një mënyrë të organizuar. Binjakëzimi i tillë mund të ofrojë mundësi për nxitjen e mirëpërkushtimit të ndërsjellë kulturor dhe të forcojë bashkëpunimin dhe përkrahjen në

nivel të vendit.

Përmes fondeve nga Programi PGI i UNESCO-s, FNAB (IFLA) ka zhvilluar një bazë të dhënash ndërkombëtare, që vepron si një pikë fokale për bibliotekat që kërkojnë partner të mundshëm binjakëzimi. Sistemi vepron si një lloj i një agjencie njohtuese për bibliotekat, duke i përshtatur bibliotekat sa të jetë e mundur më shumë, duke u bazuar në përfitimet, të cilat ato mund t'i ofrojnë partnerit. Fushat e interesit profesional, mbi të cilat mund të mbështetet partneriteti, përfshijnë:

- Këmbimin e informacioneve lidhur me bibliotekat, në përgjithësi;
- Qasjen e rritur ndaj informacionit të publikuar biobibliografik;
- Këmbimin e informacioneve mbi menaxhimin, teknologjinë dhe zhvillimet profesionale;
- Këmbimet e personelit;
- Këmbimin e materialit bibliotekar;
- Huazimet ndërbibliotekare dhe shërbimet e furnizimit me dokumente dhe
- Trajnimin e personelit dhe zhvillimin.

Një strukturë dhe një bazë e ngjashme e të dhënave mund të krijohet për të nxitur bashkëpunimin në nivel komunal, duke përfshirë institucionet kulturore të vendit, siç janë bibliotekat publike.

Përgjegjësia kryesore për këtë program i takon Konzorciumit të Bibliotekave të Kosovës.